




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

AUDITIMI I PERFORMANCËS

RAPORTI I AUDITIMIT
Performanca financiare dhe
operative NP Trepça Sh.A



Prishtinë, dhjetor 2022

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 30001¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës "Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A." në konsultim me Ndhimës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj-Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Jetmira Isufi, Udhëheqëse e Ekipit

Ardiana Miftari, Anëtare e Ekipit

Ylfete Osmani, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011 <http://zka-rks.org>

1. Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike
2. Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.
3. Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.
4. Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	5
Përmbledhje e përgjithshme	6
1 Hyrje.....	8
2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit	10
3 Gjetjet e auditimit.....	11
3.1 Procedurat e menaxhimit të kompanisë	15
3.1.1 Planet e Biznesit, Raportet Vjetore dhe Rregulloret nuk janë miratuar nga Bordi Mbikëqyrës për të gjitha njësitë biznesore	16
3.1.2 Mungesa e rregulloreve dhe procedurave standarde të brendshme të operimit dhe menaxhimit financiar	17
3.1.3 Mungesë e Zyrtarit Çertifikues të pagesave	19
3.2 Procesi i prodhimit dhe operimit	20
3.2.1 Mos realizimi i planeve të prodhimit sipas planifikimit 2019-2021.....	20
3.2.2 Rrjedhje (humbje) të mëdha të metaleve në steril.....	24
3.2.3 Mos standardizimi i procesit të punës në flotacione	26
3.3 Indikatorët e performancës financiare negative	28
3.3.1 Shpenzimet e larta të prodhimit dhe kosto e mallit të shitur	36
3.3.2 Obligime të larta ndaj furnitorëve të lëndës së parë në prodhim dhe të tjera	41
3.3.3 Trendi i rritjes ndër vite për të arkëtueshmet	45
3.3.4 Numër i lart i rasteve në konteste gjyqësore dhe përmbarimore.....	46
3.4 Investimet kapitale në teknologjinë/infrastrukturën prodhuese	47
3.4.1 Projektet kapitale të realizuara me financim nga aksionari	50
3.5 Burimet njerëzore në procesin e prodhimit	54
3.5.1 Mungesë e analizës dhe identifikimit të nevojave për angazhimin e punëtorëve në prodhim.....	57

3.5.2 Tejkalim i stafit të punësuar në krahasim me shpalljen publike me konkurs	59
3.5.3 Lëvizjet dhe gradimet e stafit nëpër pozita dhe njësi biznesore	60
3.5.4 Angazhimi i punëtorëve pa shpallje të konkursit publik, me punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta	62
3.5.5 Trajnimet e punonjësve nuk mbulojnë nevojat e njësive biznesore dhe nuk janë koordinuar si duhet	64
4 Konkluzionet.....	66
5 Rekomandimet.....	69
Shtojca I. Motivi i auditimit, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	71
Motivi i auditimit	71
Fushëveprimi i auditimit	72
Metodologjia e auditimit	72
Shtojca II. Tabelat për gjetjet e auditimit nga Kapitulli 3	74
Shtojca III. Struktura organizative	83
Shtojca IV. Foto gjatë ekzaminimit fizik të procesit të prodhimit.....	84
Shtojca V. Letër konfirmim dhe komentet e entitetit të audituar.....	86

Lista e shkurtesave

AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
BM-BPM	Bordi Mbikëqyrës, respektivisht Bordi Përkohshëm Mbikëqyrës
BM-BPM	Bordi Menaxhues, respektivisht Bordi Përkohshëm Menaxhues
BPV	Bruto Produkti Vendor
KA	Komiteti i Auditimit
KE	Kryeshef Ekzekutiv
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
LME	London Metal Exchange
ME	Ministria e Ekonomisë
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NJB	Njësi Biznesore
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PB	Plan Biznesi
PIM	Parku Industrial Mitrovicë
PMRMK	Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale në Kosovë
PV	Plan Vjetor
PZSM	Programi i Zbatimit të Strategjisë Minerare të Kosovës 2018-2020
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
SMRK	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025
SH.A.	Shoqëri Aksionare
SHGJK	Shërbimi Gjeologjik i Kosovës
TKP	Treguesit kryesorë të Performancës
UNJB	Udhëheqës i Njesisë Biznesore
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKFTH	Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit

Përmbledhje e përgjithshme

Trepça Sh.A. është Ndërmarrje Publike Qëndrore në pronësi të Qeverisë së Kosovës me 80% të aksioneve dhe 20% të tjera ju takon punëtorëve të Trepçës. Duke marrë parasysh ndikimin dhe peshën e këtij resursi pasuror për Kosovën në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit, gjenerimin e punësimit, rritjen e eksportit dhe BPV-në, Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar performancën financiare dhe operative të Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021 me fokus tek procesi i prodhimit. Fushëveprimi i auditimit ka përfshirë Njësitë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stan Tërg, Minierat me Flotacion Kishnicë-Artanë dhe Minierat me Flotacion Kopaonik-Leposaviç.

Konkluzioni i auditimit është se Trepça Sh.A. nuk ka arritur të vendosë sisteme dhe kontrole adekuate të brendshme të cilat do ta e mbështesnin arritjen e performancës financiare dhe operative pozitive, me theks në procesin e prodhimit. Si rezultat, nuk kishte arritur të jetë efikase dhe efektive në shfrytëzimin dhe përpunimin e burimeve minerare, me synim të tejkalimit të operimit me humbje mesatare mujore prej 620,307€ dhe arritjes së rentabilitetit.

Trepça Sh.A. nuk ka arritur që të krijojë parakushtet e duhura për operim të cilat do të siguronin shfrytëzim efikas dhe fitimprurës të burimeve minerare. Planet e prodhimit nuk ishin realizuar sipas planifikimit operativ dhe dinamik, planet e biznesit, raportet vjetore si dhe rregulloret e NJB Minierat me Flotacion Kopaonik-Leposaviç nuk ishin miratuar nga Bordi Mbikëqyrës. Poashtu evidente ishte mungesa e rregulloreve dhe procedurave standarde të brendshme të operimit dhe menaxhimit financiar. Rezultatet tona audituese kanë nxjerr në pah dobësi dhe mungesë efektiviteti në sistemin e kontrollit të brendshëm që do të mundësonte produktivitet të lart në nxjerrjen e xehes, përpunimin dhe pasurimin e mëtejshëm të saj. Shpenzimet e larta të prodhimit dhe shitjes ishin rrjedhojë e mos racionalizimit dhe optimalizimit, përfshirë edhe ndikimin e mungesës së zyrtarit certifikues me pasojë dobësi e kontrollit adekuat. Poashtu obligimet e larta ndaj furnitorëve të lëndës së parë dhe obligimeve tjera ishin si shkak i mungesës së planit për prioritizim të pagesave dhe kishin rritur rrezikun e ballafaqimit të kompanisë me konteste gjyqësore dhe përmbarimore përfshirë edhe shpenzime shtesë. Trendi i rritjes ndër vite për të arkëtueshmet ishte tregues i problemit të likuiditetit dhe rentabilitetit me ndikim në realizim të të hyrave dhe përmbushjes së obligimeve operative me kohë. Ndërsa analizat e indikatorëve kyç të performancës financiare kanë rezultuar me tregues negativ që tregojnë gjendjen e rënduar financiare që e ka përcjellë kompaninë ndër vite.

Teknologjia dhe infrastruktura e vjetërsuar në Trepça Sh.A dhe mungesa e investimeve kapitale ka ndikuar në produktivitet të ulët. Projektet kapitale ishin financuar kryesisht nga aksionari kryesor dhe në rastin e NJB Minierat me Flotacion Kopaonik- Leposaviç ishin financuar në mungesë të aprovimit të planit të biznesit të kësaj njësie nga Bordi Mbikëqyrës. Edhe pse disa projekte kapitale çdo vit në vazhdimësi financoheshin nga buxheti i Qeverisë, numër i lart i projekteve tjera kapitale me rëndësi vitale kishin mbetur

pa u realizuar në mungesë të fondeve dhe në pritje të financimit nga burimet jashtë kompanisë. Rrjedhjet (humbje) e mëdha të metaleve në steril gjatë procesit të flotimit të xehes ishin rezultat i teknologjisë së vjetërsuar dhe mungesës së investimeve kapitale dhe mos standardizimit të procesit të punës në flotacione.

Trepça Sh.A. nuk kishte arritur të sigurojë menaxhim optimal të burimeve njerëzore në procesin e prodhimit. Kjo, si rezultat i mungesës së analizës dhe identifikimit të nevojave për angazhim të stafit në prodhim nëpër njësi biznesore, me synim të ngritjes së produktivitetit. Mungesa dhe mos përditësimi i rregulloreve për sistematizimin e vendeve të punës ishin si rezultat i mos aprovimit nga Bordi përfshirë edhe mos koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të njësive biznesore. Shpallja e konkurseve pa qenë të planifikuara me plan biznesi, tejkalimi i stafit të punësuar në njësitë biznesore në krahasim me shpalljen e konkursit publik dhe angazhimi i punëtorëve me punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta pa shpallje të konkursit publik, janë vetëm disa raste të parregullsive të shumta të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të cilat kishin rezultuar edhe me shpenzime shtesë gjatë periudhës 2019-2021. Lëvizjet e stafit nëpër pozita dhe njësi biznesore kishin shkaktuar mungesë të stafit në prodhim tek njësitë biznesore. Poashtu evidente ishin mangësitë në koordinim të trajnimeve të stafit në prodhim.

Bazuar në gjetjet e auditimit rezulton se ka nevojë për përmirësim në procesin e prodhimit në përgjithësi dhe forcimin e kontrolleve të brendshme të Trepça Sh.A. Për të eliminuar mangësitë e identifikuara kemi dhënë 3 rekomandime për Qeverinë e Kosovës dhe 19 rekomandime për NP Trepça Sh.A të paraqitura në kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

NP Trepça Sh.A. janë pajtuar pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna. Për më shumë lidhur me komentet e NP Trepça Sh.A i gjeni në shtojcën 5.

1 Hyrje

Veprimtaria minerare është një nga veprimtaritë ekonomike më të vjetra, e cila merret me hulumtim, shfrytëzim dhe pasurim të resurseve minerale. Kosova është e pasur me resurse minerare, ku resurset energjetike dhe ato të metaleve me ngjyrë, paraqesin potencial të rëndësishëm dhe thelbësor për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit, dhe me një peshë relativisht të lartë në zhvillimin industrial. Mund të veçohen mineralet e plumbit, zinkut, argjendit dhe arit, me vendburimet dhe paraqitjet më të rëndësishme në të ashtuquajturin “Brezin Metalogjenik të Trepçës”⁵ me pjesëmarrjen më të lartë në vend⁶, si dhe mineralet silikate të nikelit dhe kobaltit, të hekurit dhe një numër i konsiderueshëm i mineraleve jo-metalore, industriale dhe të tjera. Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve minerare është një ndër shtyllat më të rëndësishme për të siguruar mbështetje për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe social, si dhe për krijimin e vendeve të punës në Kosovë. Kjo ndërlidhet edhe me prioritetet e institucioneve shtetërore të Kosovës për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe mirëqenie të qytetarëve, ku realizimi i këtyre prioritetëve varet nga planifikimi dhe zbatimi i reformave strukturore ekonomike dhe në përputhje me standardet dhe praktikën e mira të Bashkimit Evropian, të cilat mundësojnë shfrytëzimin optimal të resurseve natyrore dhe njerëzore, si bazë për zhvillim afatgjatë të vendit.⁷ Më poshtë janë prezantuar rezervat e vendburimeve minerale metalore, dhe shfrytëzimi i rezervave minerale metalore përgjatë viteve.

Tabela 1. Rezervat e vendburimeve të Plumbit (Pb), Zinkut (Zn) dhe Argjendit (Ag)⁸

Miniera	Kategoria	Ton	Pb (%)	Zn (%)	Ag/g t
Stantërg	A+B+C1	12,319,303	3.96	2.61	65.44
Artanë (Përroi i ngjyrosur dhe Kaltrina)	A+B+C1	7,91,014	2.62	3.14	106.23
Hajvali, Badovc, Kishnicë	A+B+C1	4,675,000	5.49	4.17	79.9
Belloberdë	A+B+C1	1,995,979	7.5	5.87	87
Cërnac	A+B+C1	2,377,548	5.1	3.18	66
Totali	A+B+C1	28,481,844	4.08	3.2	80.1

5. Burimi i informacionit : <https://www.kosovo-mining.org/resurset-minerale/statistika/>

6. Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025

7. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2020 (SKZH)

8. Plani për Menaxhimin e Mineraleve të Resurseve të Kosovës, 2010,dhe KPMM: <https://www.kosovo-mining.org/resurset-minerale/statistika/>

Tabela 2. Shfrytëzimi i rezervave minerale metalore në Kosovë përgjatë viteve 2017-2020, si dhe planifikimi për vitin 2021⁹

Lënda minerale	Përshkrimi	Viti				
		2017	2018	2019	2020	2021
Pb-Zn	Planifikimi	349,382	349,382	363,605	312,520	214,000
	Rezervat e shfrytëzuara	223,373	238,576	204,079	209,017	/

Qeveria, respektivisht Ministria e Ekonomisë (ish MZHE) ka përgatitur **Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën kohore 2012-2025**, e cila përbën kornizën themelore, në bazë të së cilës përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit minerar.

Si mekanizëm i domosdoshëm për zbatimin e Strategjisë Minerare është **Programi i Zbatimit të Strategjisë Minerare 2018-2020**¹⁰ dokument ky afatmesëm i planifikimit minerar dhe i cili është hartuar në bazë të Strategjisë Minerare, ku Ministria e Ekonomisë (ish MZHE) ka detajuar politikat, alokimin e detyrave, ndërmarrjen e aksioneve specifike si dhe monitorimin e progresit të realizimit të Strategjisë Minerare.

Dokument i rëndësishëm i Strategjisë Minerare është edhe **Plani i menaxhimit të resurseve minerale**¹¹ ku sipas kërkesave të legjislacionit projekt plani duhet të përgatitet nga KPMM-ja, dhe të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare. Njëkohësisht, autoritetet kompetente kanë nxjerrë një sërë aktesh nënligjore dhe udhëzimesh administrative që rregullojnë aktivitetin minerar në Kosovë, në pajtueshmëri me legjislacionin për minierat dhe mineralet.¹²

9. Raporti vjetor 2020, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)

10. Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare të Kosovës për periudhën 2018-2020 (PZSM)

11. Plani i menaxhimit të resurseve minerale për vitin 2016

12. Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, dhe Ligji Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet

2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësojë nëse NP Trepça ka vendosur sisteme dhe kontrole adekuatë të cilat e mbështesin arritjen e performancës financiare dhe operative pozitive, me fokus në procesin e prodhimit. Nëse jo, cilët janë shkaktarët që ndikojnë në produktivitetin e ulët, mungesën e rentabilitetit respektivisht profitabilitetit. Përmes këtij auditimi synojmë dhënien e rekomandimeve që mund të kontribuojnë në përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të performancës së kompanisë, duke marrë parasysh rëndësinë dhe potencialin që ka në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit, përfshirë gjenerimin e punësimit, ndikimin pozitiv në eksport si dhe rritjen e BPV.

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit janë parashtruar pyetjet si në vijim.

Pyetjet kryesore të auditimit:

1. A janë krijuar parakushtet e duhura për operim dhe a janë ndërmarr masat e nevojshme për të siguruar shfrytëzim efikas dhe fitimprurës të burimeve minerale?
2. A behet vlerësimi i nevojave për investime kapitale me qëllim të ngritjes së produktivitetit dhe sigurimit të vazhdimësisë së procesit të prodhimit?
3. A e ka të rregulluar siç duhet NP Trepça fushën e burimeve njerëzore e cila do të siguronte proces efektiv të prodhimit?

Ky auditim ka përfshirë në fushëveprim periudhën 2019-2021. Ndërsa për qëllime krahasuese dhe analitike janë përdorur të dhëna deri në pesë (5) vite para prapake.

Në këtë raport Flotacioni Tuneli i Parë nënkupton NJB Minierat me Flotacion Stan Tërg, Flotacioni Kishnicë nënkupton NJB Minierat me Flotacion Kishnicë-Artanë ndërsa Flotacioni Leposaviç nënkupton NJB Minierat me Flotacion Kopaonik-Leposaviç. Për çështje të raportimit, shifrat e prezantuara në raport janë rrumbullaksuar.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në *Shtojcën 1*, ndërsa përshkrimi detaj i sistemit dhe përgjegjësitë e palëve relevante janë të paraqitura në *Shtojcën 2* të këtij raporti.


3 Gjetjet e auditimit

Rezervat e plumbit dhe zinkut janë faktor kyç për realizimin e prodhimit në minierat dhe flotacionet e Trepça Sh.A. Eksploatimi i xehes në *minierat aktive në Stan Tërg dhe Artanë*, si dhe prodhimi i koncentratit të plumbit (Pb) dhe zinkut (Zn) në *Flotacionin e Tunelit të parë dhe Flotacionin e Kishnicës*, janë aktiviteti primar biznesor prodhues nga të cilat gjenerojnë të hyrat kryesore këto njësi biznesore të Trepça Sh.A. Ndërsa, Miniera dhe Flotacioni Kishnicë-Artanë nuk prodhojnë gjatë periudhës dhjetor deri në mars, për shkak të kushteve klimatike dhe terrenit.

*Minierat Čërnac dhe Bello Bërdo*¹³ janë njësitë punuese kryesore aktive të NJB Kopaonik-Leposaviç që shfrytëzohen për eksploatimin e xehes, dhe më tutje xehja transportohet përmes kamionëve deri në *Flotacionin në Leposaviç* për përpunim/pasurim të mëtejshëm.

Kapaciteti i prodhimit në tonelata/vit në minierat dhe flotacionet e Trepça Sh.A. është paraqitur në grafikun si vijon:

Grafiku 1. Kapaciteti i prodhimit (ton/vit)¹⁴



Sa i përket ushtrimit të aktivitetit të saj primar biznesor lidhur me eksploatimin e xeheve (mineraleve) dhe përpunimin e mëtejshëm të tyre, NJB të Trepça Sh.A. respektivisht Minierat dhe Flotacionet janë pajisur nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) me Licencë Shfrytëzimi dhe Leje për Aktivitetet e Veçanta.¹⁵

13. Gjatë fazës së planifikimit të auditimit, me dt.13/12/2021 ekipi prej dy auditorëve ka vizituar Minierën Bello Bërdo dhe Flotacionin në Leposaviç. Gjatë vizitës nuk është lejuar fotografimi.

14. Sipas Planit Strategjik të Ndërmarrjes “Trepça – Sh.A”


15. Në baza tremujore dhe vjetore Trepça Sh.A. sipas kërkesave ligjore obligohet të dorëzojë tek KPM, Raporte të punës për licencat e shfrytëzimit dhe lejet për aktivitetet e veçanta.

NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë eksploatimin e xehes dhe prodhimin e koncentratit e sigurojnë nga burimet e veta njerëzore të angazhuar në prodhim. NJB Kopaonik – Leposaviç, 30% të punëve minerare në prodhim të planifikuar e ka kontraktuar nga jashtë përmes kontraktuesve me seli nga Leposaviç dhe Loznica, që përfshijnë punë kërkimore-përgatitore dhe nxjerrje të xeheve dhe gjërmim të hapësirave horizontale dhe vertikale në miniera. Shuma e kontratave të lidhura për periudhën 2019-2021 ishte 3,174,830 € dhe të cilat janë paraqitur në Shtojcën II të raportit, tabela 24.2.

Minierat dhe flotacionet përgatitin planet operative të prodhimit mujor si dhe planin dinamik të prodhimit vjetor. Plani i prodhimit përmban dinamikën mujore të nxjerrjes së xeheve dhe të dhënat për sasinë e metaleve.

Tregu në të cilin operon Trepça Sh.A. për shitjen e koncentrateve, është tregu evropian, ku përmes tenderimit ndërkombëtarë përzgjedhin blerësit, përderisa furnizimi¹⁶ me material shpenzues dhe makinerik realizohet përmes tregut të brendshëm dhe të jashtëm. Procesi i tenderimit nuk është i centralizuar për të gjitha njësitë biznesore të Trepça Sh.A. dhe se zhvillohet në mënyrë të pavarur nga NJB Kopaonik-Leposaviç, poashtu kontratat e shitjes me blerësit lidhen ndaras nga kjo njësi biznesore. Kontratat e shitjes janë lidhur me blerës nga shtetet e ndryshme si Londër-Mbretëri e Bashkuar; Plovdiv-Bullgari; Bukowno-Poloni; dhe Singapor, ndërsa kontratat e shitjes së plumbit të rafinuar dhe të papërpunuar janë lidhur me operatorë me seli në Beograd, Ada-Republika e Serbisë. Në vijim kemi paraqitur në mënyrë grafike shtetet në të cilat është destinuar eksporti i Trepça Sh.A.:

Grafiku 2. Shtetet e destinimit të eksportit të koncentrateve dhe plumbit të rafinuar për periudhën 2019-2021




16. Trepça Sh.A. nuk aplikon sistem elektronik unik/të integruar të E-prokurimit për zhvillim të procedurave të prokurimit për të gjitha njësitë biznesore.

Menaxhimi i kontratave të shitjes në kuadër të NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë bëhet nga Divizioni i shitjes dhe qirasë, i cili përbëhet nga Drejtori dhe dy zyrtarë të shitjes dhe qirasë. Ndërsa, menaxhimi i kontratave të shitjes në kuadër të NJB Kopaonik-Leposaviç bëhet nga Shërbimi i shitjes nën sektorin e marketingut.

Të dhënat në vazhdim paraqesin eksportet/shitjet e koncentrateve nëpër vite, nga Flotacioni Tuneli i Parë, Flotacioni Kishnicë, Flotacioni Kopaonik-Leposaviç dhe Metalurgjia e Plumbit-Zveçan:


Grafiku 3. Eksportet/shitja e koncentrateve nga Flotacioni Tuneli i Parë, Flotacioni Kishnicë¹⁷ dhe Flotacioni Kopaonik-Leposaviç, si dhe plumbit të rafinuar nga Metalurgjia e Plumbit -Zveçan për periudhën 2019-2021¹⁸



17. Raportet vjetore 2019-2021


18. Raportet e realizimit të shitjes 2019-2021

Grafiku 4. Të hyrat nga shitja e koncentrateve nga Flotacioni Tuneli i Parë, Flotacioni Kishnicë¹⁹ dhe Flotacioni Kopaonik-Leposaviç, si dhe plumbit të rafinuar nga Metalurgjia e Plumbit -Zveçan për periudhën 2019-2021²⁰



Meqenëse produktet e veta i shet në tregun e jashtëm, Trepça Sh.A. çdoherë është nën ndikimin e lëkundjeve që pësojnë çmimet e metaleve në tregun ndërkombëtarë në berzën LME dhe LBMA²¹, si dhe transaksionet e shitjes së koncentrateve kryhen në valutën USD dhe pastaj konvertohen në Euro. Në vazhdim janë paraqitur çmimet mesatare vjetore të metaleve në berzë për vitet 2019-2021:

Grafiku 5. Çmimet mesatare vjetore të metaleve sipas berzës LME Londër, në valutën Euro dhe USD



19. Raportet vjetore 2019-2021

20. Raportet e realizimit të shitjes 2019-2021

21. London Bullion Market Association

3.1 Procedurat e menaxhimit të kompanisë

NP Trepça Sh.A. është trashëguar nga ish ndërmarrja shoqërore Kombinati Xehëtaro-Metalurgjik Trepça, si një nga komplekset më të mëdha industriale, metalurgjike dhe kimike i bazuar në Kosovë dhe me pasuri tjera edhe jashtë Kosovës. Në të kaluarën, ky kompleks mineral ishte një gjigant industrial i cili përfaqësonte një burim të konsiderueshëm ekonomik.

Transformimi i Trepçës u formalizua në vitin 2016 përmes miratimit të Ligjit për Trepçën²² në Kuvendin e Kosovës, ku nga statusi i Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh.) nën administrim të AKP-së, Trepça kalon në statusin e Ndërmarrjes Publike (NP). Menaxhimi i pronësisë me 80% të aksioneve ushtrohet nga aksionari kryesor i korporatës Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Ekonomisë përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP). Ndërsa 20% e aksioneve ju takon punëtorëve të Trepçës²³.

Trepça Sh.A. për administrimin dhe funksionimin e saj duhet të përgatit Planin e Biznesit dhe Raportin Vjetor të integruar duke përfshirë të gjitha njësitë biznesore sipas statutit të kompanisë dhe legjislacionit për Trepça Sh.A. Njëkohësisht të nxjerr, vë në fuqi dhe rishikojë në baza të rregullta, rregulloret e kompanisë të cilat ndihmojnë operimin e saj.

Gjatë vitit 2019 Trepça Sh.A. ka funksionuar me Bord²⁴ në përbërje prej shtatë anëtarësh duke përfshirë edhe KE, ndërsa gjatë periudhës 2020-2021 ka funksionuar me Borde të Përkohshme Mbikëqyrëse me përbërje prej pesë anëtarë, dhe respektivisht gjatë periudhës Nëntor 2021 deri në Shkurt 2022 ka funksionuar pa Bord Mbikëqyrës. Bordi Menaxhues²⁵ nuk ka qenë plotësisht funksional, dhe kryesisht ka funksionuar me ushtrues detyre (Ud.) si rrjedhojë e lëvizjeve dhe ndryshimeve të shpeshta, ku vetëm gjatë periudhës 2019-2021 janë ndërruar shtatë Kryeshef Ekzekutiv, dy Udhëheqës të NJB-ve: NJB Stan-Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe Metalurgjia e Zinkut. Lëvizje dhe ndryshime ka pasur edhe në pozitat e zyrtarëve të tjerë të lartë, si: Sekretar Koorporativ, dhe Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit, ku edhe këto pozita kanë funksionuar me ushtrues detyre dhe ndërrime të zyrtarëve dy herë për secilën pozitë. Njësia e auditimit të brendshëm ka funksionuar me dy auditorë dhe nuk ka qenë plotësisht funksionale.

Në Shtojcën III të këtij raporti është paraqitur struktura organizative e Trepça Sh.A.

22. Nën menaxhim të AKP-së kanë mbetur asetet jothelbësore dhe jo profitabile për t'iu nënshtruar privatizimit ose likuidimit në përputhje me kornizën ligjore për privatizim. Njëkohësisht, legjislacioni për Trepçën obligon AKP-në që t'i ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për t'i realizuar të drejtat e Kosovës dhe të Trepçës lidhur me asetet e Trepçës në vendet e tjera.

23. Trepça Sh.A. ende nuk ka arritur të bëjë regjistrimin e punëtorëve si aksionar të 20% të aksioneve. Në pajtueshmëri me Ligjin për Trepçën, në vitin 2019 u miratua nga aksionarët Statuti i Trepça Sh.A.

24. Bordi Mbikëqyrës sipas kërkesave ligjore duhet të përbëhet nga nëntë anëtarë të zgjedhur nga aksionarët sipas pjesëmarrjes në kapital dhe procedurave që përcaktohen në statut

25. Bordi Menaxhues sipas kërkesave ligjore duhet të përbëhet nga: Kryeshefi Ekzekutiv, zv.Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësit e Njësive Biznesore

3.1.1 Planet e Biznesit, Raportet Vjetore dhe Rregulloret nuk janë miratuar nga Bordi Mbikëqyrës për të gjitha njësitë biznesore

Ndërmarrja Publike duhet të nxjerr dhe vë në fuqi të gjitha rregulloret për administrimin dhe funksionimin e e saj, dhe se miratimi, ndryshimi, plotësimi si dhe shfuqizimi i Rregulloreve është kompetencë ekskluzive e Aksionarit(ëve) përfshirë edhe miratimin e Planit të Biznesit. Bordi Mbikëqyrës ka detyrë dhe përgjegjësi miratimin e raportit vjetor të shoqërisë dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve të cilat pastaj dorëzohen tek aksionarët për miratim.²⁶

NJB Kopaonik-Leposaviç nga aspekti organizativ, rregullativ dhe financiar ka operuar në mënyrë të ndarë edhe pse në bazë të ligjit është njësi e pandashme e Trepça Sh.A, për më tepër as për afarizmin e saj nuk ka raportuar tek Bordi. Për çdo vit fiskal ka hartuar Planin e Biznesit si dhe Raportin Vjetor të aktivitetit operativ dhe financiar të kësaj njësie biznesore të Trepça Sh.A. Mirëpo këto plane dhe raporte nuk janë miratuar nga Bordi Mbikëqyrës të cilët kanë për detyrë dhe përgjegjësi miratimin e raportit vjetor të shoqërisë dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve. Njëkohësisht rregulloret me të cilat operon NJB Kopaonik- Leposaviç nuk janë rishikuar dhe miratuar në Bord edhe pse për miratimin, ndryshimin, plotësimin si dhe shfuqizimin e Rregulloreve është kompetencë e Aksionarit përfshirë edhe miratimin e Planit të Biznesit.

Kjo si rrjedhojë e mungesës së koordinimit dhe bashkëpunimit të duhur të NJB Kopaonik-Leposaviç dhe mos ushtrimit të kompetencave të Bordit Mbikëqyrës. Mungesa e miratimit nga Bordi Mbikëqyrës të Planit dhe Raportit Vjetor si dhe rregulloreve të NJB Kopaonik-Leposaviç, dhe mos përfshirja e tyre në Plan Biznesin dhe Raportin Vjetor të integruar/konsoliduar të Trepça Sh.A., paraqet devijime nga korniza për ndërmarrjet publike, ku kërkohet përgatitja dhe miratimi i dokumenteve të tilla si dhe kornizës rregullative për kompaninë si tërësi.

Ndërsa për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, Bordi Mbikëqyrës nuk kishte aprovuar Planin e Biznesit për vitin 2019, ku për dallim nga viti 2020 dhe 2021 planet e tilla ishin aprovuar. Sipas konfirmimeve nga zyra ligjore, nuk ka ndonjë sqarim pse ka ndodhur kjo situatë. Rastet e tilla përveç që paraqesin devijime, rrezikojnë me planifikim jo të mirëfilltë të aktiviteteve operative dhe financiare të njësisë biznesore, konform rrethanave dhe gjendjes reale të kompanisë.

Poashtu, në Planet e Biznesit të NJB Kopaonik-Leposaviç nuk ishte paraparë planifikimi për punësimin e stafit për plotësimin e vendeve të lira të punës mirëpo në plan ishin paraqitur vetëm sfidat për fuqinë punëtore. Kjo si rrjedhojë e mungesës së identifikimit të saktë të nevojave nga ana e kësaj njësie biznesore. Mungesa e planifikimit për plotësimin e vendeve të lira të punës mund të ketë implikime buxhetore të pa planifikuara.

26. Statuti NP Trepça Sh.A., neni 19, pika 2

3.1.2 Mungesa e rregulloreve dhe procedurave standarde të brendshme të operimit dhe menaxhimit financiar

Trepça Sh.A. duhet të nxjerr dhe vë në fuqi të gjitha rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë .Miratimi, ndryshimi , plotësimi si dhe shfuqizimi i Rregulloreve të NP është kompetencë ekskluzive e Aksionarit(ëve).Dispozitat e rregulloreve duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në dispozitat përkatëse.²⁷ Rregulloret e NP-ve duhet të përmbajnë dispozita të cilat përshkruajnë në mënyrë të hollësishme titujt, detyrat dhe kompetencat e secilit zyrtar të NP-së.²⁸

Trepça Sh.A. ka funksionuar pa rregullore dhe procedura të brendshme për operim financiar të miratuara në Bordin Mbikëqyrës, ku do të përshkruheshin dhe detajizoheshin punët, aktivitetet, procedurat dhe proceset brenda Departamentit të Financave dhe Thesarit, si departament kyç për menaxhimin dinamik të proceseve që lidhen me qarkullimin fizik dhe financiar të aseteve, aktivitetet rreth menaxhimit të kërkesave dhe detyrimeve ndaj palëve në transaksione, si dhe menaxhimin e çështjeve financiare sipas kërkesave ligjore.

Mungojnë rregulloret dhe procedurat standarde për kategoritë e shpenzimeve, stoqet, pasuritë tjera qarkulluese dhe jo qarkulluese, menaxhimin e arkës, llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme me theks politikat kontabël në lidhje me kalkulimin e vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme. Njëkohësisht, nuk ka rregullore për procedurat standarde të marketingut. Ndërsa duhet theksuar se vetëm gjatë vitit 2021 Trepça Sh.A. kishte arritur të miratojë në Bordin Mbikëqyrës rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, si dhe rregullorën për procedurat e avanseve dhe shpenzimeve me paranë e imët dhe avancet për udhëtimet zyrtare.

Trepça Sh.A deri në vitin 2020 kishte funksionuar pa rregullore të qirasë të hartuar dhe miratuar në Bordin Mbikëqyrës. Kontratat bazë të qiradhënies i kishte vazhduar me anekse, dhe pa ndonjë rishikim dhe harmonizim të çmimeve të qirasë. Ndërsa, në përfundim të vitit 2020 kishte arritur të hartojë, dhe miratojë në Bordin Mbikëqyrës rregulloren që përcakton të hyrat nga dhënia me qira e pronës së paluajtshme, ku kjo rregullore aktualisht është në zbatim vetëm nga NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë mirëpo jo edhe nga NJB Kopaonik-Leposaviç. Ende nuk ka të hartuar dhe miratuar rregullore për llojet e të hyrave tjera, ku do të përcaktoheshin rregullat dhe procesi i punës për secilin lloj të të hyrave, politikat e shitjes dhe plani operativ real gjithëpërfshirës si pjesë e strategjisë së shitjes, përfshirë planin e rritjes së konsumatorëve, procedurat e tenderimit dhe aprovimit të kontratave të shitjes, si dhe ciklin e menaxhimit dhe realizimit të kontratave të shitjes.

27. Statuti NP Trepça Sh.A. neni 8 pika 1; Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike neni 34 pika 34.1

28. Statuti NP Trepça Sh.A. neni 8 pika 1; Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike neni 34 pika 34.1, 34.3 pika a)

Për më tepër mungojnë procedurat standarde të operimit të miratuara në Bordin Mbikëqyrës, që përshkruajnë dhe detajizojnë punët, aktivitetet, dhe procedurat brenda Departamentit të Shitjes, si dhe përcaktimin e mënyrës së funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij departamenti dhe bashkëveprimin me departamentet dhe njësitë tjera. Deri në vitin 2020, Departamenti i shitjes së Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë ka udhëhequr procedurat e shitjes, ka nënshkruar dhe menaxhuar kontratat e shitjes, ndërsa nga viti 2021 kontratat e shitjes nënshkruhen nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Sipas konfirmimit që kemi pranuar nga zyra ligjore e Trepça Sh.A., çështjet e lartcekura nuk ishin të rregulluara përmes rregullores, si dhe ndikim kishin poashtu edhe lëvizjet dhe ndryshimet e shpeshta në strukturat e larta menaxhuese të kompanisë.

Mungesa e rregulloreve, politikave dhe procedurave standarde të operimit ka ndikim në aktivitetet operative të kompanisë, menaxhimin e të hyrave, administrim dhe funksionim të tërësishëm të kompanisë si dhe me ndikim në varianca të mëdha tek zërat financiar të cekur.

Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A në vitin 2019²⁹, ka nxjerrë vendim që të iniciohet hartimi i rregullores dhe organogramit për sistematizimin e vendeve të punës në të gjitha NJB të Trepça Sh.A., mirëpo edhe pse ka pas iniciativë, ende nuk është arritur të hartohet dhe aprovohet. NJB Kopaonik-Leposaviç nuk ka përditësuar rregulloret që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Trepça Sh.A. dhe se ende vepron me rregullore të pa përditësuara. Mos hartimi dhe aprovimi i rregullores ka ndodhur si rezultat i mos përkushtimit dhe angazhimit të duhur të stafit menaxhues të Trepça Sh.A. si dhe për shkak të ndërrimeve dhe lëvizjeve të shpeshta të stafit në pozita drejtuese dhe Bordit Mbikëqyrës.

Si pasojë e mungesës së rregullores në Trepça Sh.A. mund të pamundësohet maksimizimi i përfitimit të punëtorëve nëpër vendet e tyre të punës sipas aftësive dhe kompetencave profesionale. Gjithashtu, mos përditësimi i rregullores dhe politikave të brendshme për përshkrimin/sistematizimin e vendeve të punës si dhe aprovimi i tyre në Bordin Mbikëqyrës, mund të pamundësojë sistematizimin e punëtorëve nëpër vendet e tyre të punës në përputhje me rrethanat dhe gjendjen aktuale në Trepça Sh.A.


29. Vendimet e Bordit Mbikëqyrës nr.039/19 të dt.09.07.2019

3.1.3 Mungesë e Zyrtarit Çertifikues të pagesave

Çdo ndërmarrje publike duhet ta ketë Zyrtarin Certifikues. Zyrtari Çertifikues është përgjegjës të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës.³⁰

Kompania nuk kishte emëruar zyrtar për certifikimin e pagesave. Këtë rol e mbulonte pjesërisht, Zyrtari Kryesor Financiar, mirëpo kjo nuk është një ndarje e duhur e detyrave pasi që i njëjti menaxhon edhe me llogaritë bankare dhe bën certifikimin e pagesave. Për më tepër, pozita e zyrtarit certifikues nuk ishte paraparë as në strukturën organizative të kompanisë. Sipas konfirmimeve të u.d. Kryeshefit Ekzekutiv, kjo pozitë do të mbulohet përmes procedurave të rekrutimit. Ne nuk kemi arritur të sigurojmë ndonjë informacion shtesë se përse nuk ishte mbuluar kjo pozitë më parë.

Mungesa e Zyrtarit Çertifikues reflekton me zvogëlim të kontrollit efektiv dhe monitorimit nga ana e menaxhmentit, për përmbushje të kërkesave kontraktuale para autorizimit të pagesave.



30. Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221 dhe Ligjin Nr.04/L-116, neni 2: Përkufizimi “Rregullat e KMF” riformulohet si në vijim: “Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit (MFK)” është një sistem gjithëpërfshirës i politikave, procedurave, aktiviteteve dhe përgjegjësi për të menaxhuar dhe kontrolluar shfrytëzimin e fondeve publike, ku përfshihen të hyrat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet, bazuar në menaxhimin e rrezikut, me qëllim të ofrimit të sigurisë, që objektivat e institucionit do të arrihen në mënyrë ligjore, ekonomike, efikase dhe efektive

3.2 Procesi i prodhimit dhe operimit

3.2.1 Mos realizimi i planeve të prodhimit sipas planifikimit 2019-2021

Bordi Menaxhues ka për detyrë menaxhimin e shoqërisë, i cili udhëheq politikat operative dhe është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm biznesor të shoqërisë.³¹ Plani i Biznesit duhet të analizojë një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre, mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve, si dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve.³² Ndërmarrja Publike e ushtron veprimtarinë me qëllim të rritjes afat-gjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksionarëve.³³

Trepça Sh.A. në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj do të krijojë mundësi për të qenë atraktive për investues privatë; vendore dhe të jashtëm, në format si: partneriteti publiko-privat; investime direkte private; investime të përbashkëta; emetimi dhe shitja e aksioneve³⁴.

Njësitë biznesore, Minierat me Flotacion Stan Tërg, Minierat me Flotacion Kishnicë-Artanë, Minierat Belo Bërdo dhe Cërnac si dhe Flotacioni Leposaviç, janë aktive dhe aktiviteti kryesor i tyre biznesor është hulumtimi, eksploatimi, nxjerrja e xeheve dhe prodhimi i koncentratit të plumbit (Pb) dhe zinkut (Zn), dhe në pjesëmarrje më të vogël edhe metaleve tjera përcjellëse (arit dhe argjendit). Këto katër miniera përbëjnë 50% të depozitave gjeologjike të Trepçës. Ndërsa minierat tjera janë jo aktive për shkak se janë të përmbytura në ujë.

Trepça Sh.A. nuk kishte arritur të përmbushë objektivat e saj edhe përkundër faktit se me Plan Biznesi ishte paraparë realizimi i eksploatimit të xeheve në minierën me flotacion Stan Tërg duke filluar nga 180,000t/vit për të vazhduar rritjen çdo vit nga 50,000 t/vit, dhe realizimi i prodhimit të xeheve në minierën me flotacion Kishnicë-Artanë duke filluar nga 100,000 t/vit për të vazhduar rritjen çdo vit nga 10,000 t/vit.³⁵

Në vazhdim paraqesim pasqyrën e performancës operative dhe rezultatet për eksploatimin e xeheve dhe prodhimin e koncentratit të plumbit dhe zinkut të NJB Miniera Stan Tërg me Flotacion Tuneli i Parë, Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë dhe Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç, për periudhën 2019-2021:

31. Statuti NP Trepça Sh.A., neni 21, pika 1


32. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 30

33. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 12

34. Ligji Nr. 05/L-120 për Trepçën

35. Planet e Biznesit 2020 dhe 2021, Trepça Sh.A.

Grafiku 6. Planifikimi dhe realizimi i eksploatimit të xehes në Miniera 2019-2021



Diferencat në realizim të eksploatimit të xehes për secilën NJB i paraqesim në tabelën në vijim:

Grafiku 7. Diferencat në realizim të planit të eksploatimit të xehes 2019-2021




Realizimi i eksploatimit të xehes nga Miniera Stan Tërg kishte shënuar trend rritës gradual me 24.78% nga viti 2019 në vitin 2020 dhe me 26.94% në vitin 2021, ku për dallim, eksploatimi i xehes në Minierën e Artanës kishte rënie të dukshme nga viti 2019 në vitin 2020 me 20.72% për të vazhduar me ngritje të lehtë prej 14.40% në vitin 2021. Eksploatimi i xehes nga Miniera Cërnac ishte dukshëm më mirë në vitin 2019 duke shënuar rënie graduale gjatë vitit 2020 dhe 2021 me 28.10% dhe respektivisht 5.72%, ndërsa eksploatimi i xehes në Minierën Bello Bërdo kishte shënuar ngritje nga viti 2019 në vitin 2020 me 7.70% dhe rënie prej 6.54% gjatë vitit 2021.

Planifikimin dhe realizimin e prodhimit të koncentratit të plumbit për secilën NJB e kemi paraqitur si vijon:

Grafiku 8. Planifikimi dhe realizimi i prodhimit të koncentratit të plumbit 2019-2021


Diferencat në realizim të prodhimit të koncentratit të plumbit për secilën NJB i paraqesim në tabelën në vijim:

Grafiku 9. Diferencat në realizim të planit të prodhimit të koncentratit të plumbit 2019-2021

Realizimi i prodhimit të koncentratit të plumbit nga Flotacioni Tuneli i Parë kishte shënuar trend rritës të lehtë përgjatë viteve respektivisht nga viti 2019 në vitin 2020 me 12.81% dhe në vitin 2021 me 13.48%, ndërsa prodhimi i koncentratit të plumbit nga Flotacioni Kishnicë ka shënuar rënie të dukshme nga viti 2019 në vitin 2020 me 14.27% dhe me një ngritje të lehtë në vitin 2021 prej 14.99%. Prodhimi i koncentratit të plumbit nga Flotacioni Leposaviç kishte shënuar trend zvogëlues gradual nga viti 2019 dhe tutje deri në vitin 2021 me diferenca prej 5.64% dhe 5% për Cërnac dhe diferencat për Bello Bërdo në vitin 2020 ishin progresive me 16.15% për të shënuar regres në vitin 2021 me 7.77%.


Planifikimin dhe realizimin e prodhimit të koncentratit të zinkut për secilën NJB e kemi paraqitur si vijon:

Grafiku 10. Planifikimi dhe realizimi i prodhimit të koncentratit të zinkut 2019-2021



Diferencat në realizim të prodhimit të koncentratit të zinkut për secilën NJB i paraqesim në tabelën në vijim:

Grafiku 11. Diferencat në realizim të planit të prodhimit të koncentratit të zinkut 2019-2021



Realizimi i prodhimit të koncentratit të zinkut nga Flotacioni Tuneli i Parë kishte përgjatë viteve 2019-2021 kishte shënuar rritje prej 6.50% dhe 25.87%, ndërsa realizimi i prodhimit nga Flotacioni Kishnicë ka shënuar rënie prej 7.86% nga viti 2019 në vitin 2020 për të shënuar përmirësim të lehtë në vitin 2021 me 28.26%. Prodhimi i koncentratit të zinkut

nga Flotacioni Leposaviç për Cërnac dhe Bello Bërdo ishte dukshëm më mirë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 me rritje progresive prej 20.22% dhe 17.12% , për të shënuar rënie gjatë vitit 2021 me 11.42% dhe 6.25% për njësitë respektive.

Devijimet e realizimit të planeve të prodhimit nga planifikimi për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë janë rrjedhojë e ndërprerjeve në punë nga punëtorët në prodhim për shkak të mos pagesës së pagave me kohë, ndërprerjeve në procesin e prodhimit si rezultat i mungesës së lëndës së parë për shkak të mos pagesës së obligimeve me kohë ndaj kontraktorëve, defekteve teknike të makinerisë gjatë procesit të prodhimit, dhe rrezikut nga përmbytja e minierave. Miniera me Flotacioni Kishnicë-Artanë nuk ka operuar dhe prodhuar gjatë sezonit dimëror për shkak të kushteve klimatike dhe terrenit.

Ndërsa, NJB Kopaonik-Leposaviç kishte ndërprerë kontratën “Punë kërkimore-përgatitore dhe nxjerrje të xeheve në horizontin V, VI, VII dhe VIII në Minierën Cërnac”³⁶, si rezultat i mos realizimit të prodhimit sipas planit operativ mujor të prodhimit dhe kërkesave të kontratës.

Poashtu faktor tjetër që kishte rënduar realizimin e planeve të prodhimit ishte edhe situata me COVID-19 që kishte vazhduar nga viti 2020, ku në disa raste ishte ndërprerë puna apo ishte aplikuar puna me rotacion dhe me staf të reduktuar, për dallim nga viti 2019.

Mos realizmi i planifikimit të prodhimit ka ndikim direkt në të hyrat e kompanisë, duke marrë parasysh se të hyrat kryesore gjenerohen nga ky aktivitet primar biznesor, dhe ka ndikim edhe në ecurinë e realizimit të kontratave të shitjes me blerësit gjatë vitit.

3.2.2 Rrjedhje (humbje) të mëdha të metaleve në steril

Bordi Menaxhues ka për detyrë menaxhimin e shoqërisë, i cili udhëheq politikat operative dhe është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm biznesor të shoqërisë.³⁷ Ndërmarrja Publike e ushtron veprimtarinë me qëllim të rritjes afat-gjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksionarëve.³⁸ Objektivi e Trepça Sh.A. është rekonstruimi i flotacioneve me pajisje moderne për pasurimin e xeheve me qëllim të rritjes së shkallës së shfrytëzimit dhe zvogëlimit të humbjeve-rrjedhjeve në djerrina.³⁹

Trepça Sh.A. ka tri flotacione aktive. Flotacioni Tuneli i Parë është aktivizuar në vitin 1984 me kapacitet 1-1,5 Mt/v, Flotacioni në Kishnicë është i viteve të '60 dhe me kapacitet për seksion 0,5 Mt/v, dhe Flotacioni në Leposaviç i cili është revonuar në vitet e fundit dhe ka kapacitet 0,6 Mt/v. Xehja e transportuar nga minierat, në flotacione i nënshtrohet disa proceseve fiziko-kimike ku përmes flotimit prodhohet koncentrat i plumbit dhe koncentrat i zinkut, ku këto prodhime gjysmë të gatshme trajtohen si produkte finale, pasi që nuk ka mundësi të përpunohen më tutje në zingjirin metalurgjik. Në flotacione,

36. Numri i kontratës: TRC 001/2020

37. Statuti NP Trepça Sh.A., neni 21, pika 1

38. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 12

39. Planet e Biznesit për vitin 2020 dhe 2021

kryhen analizat laboratorike për përbërjen dhe kualitetin e xehes dhe koncentratit, të cilat shërbejnë më tutje për procedurat e shitjes. Në vijim kemi paraqitur pasqyrën për rrjedhën mesatare të metaleve 2019-2021, për NJB Stan Tërg -Flotacionin Tuneli i Parë dhe NJB Artanë-Flotacionin në Kishnicë.

Tabela 3. Rrjedha mesatare e metaleve, NJB Stan Tërg- Flotacioni Tuneli i Parë

Flotacioni në Tunelin e Parë - Sasia e xehes së flotuar, Koncentrati dhe Djerrina							
Viti	Sasia e xehes që është flotuar në (t)- E matur në peshoren 31	Koncentrati i fituar nga flotimi i xehes në (t)		Sasia e Djerrinës (Sterilit) në (t)	Rrjedhja e metalit në Djerrinë (steril) (%)		
		K/Pb	K/Zn		Pb (%)	Zn(%)	Ag (gr/t)
2019	99,066	3,874	4,303	90,889	0.28	0.40	-
2020	131,708	4,443	4,602	10,222	0.35	0.43	-
2021	180,285	5,135	6,208	14,078	0.30	0.39	6.18

Tabela 4. Rrjedha mesatare e metaleve, NJB Artanë- Flotacioni në Kishnicë

Flotacioni në Kishnicë - Sasia e xehes së flotuar, Koncentrati dhe Djerrina						
Viti	Xehe e flotuar, pa lagështi (t)	Sasia e koncentratit të prodhuar (t)		Sasia e Djerrinës (Sterilit) në (t)	Rrjedhja e metalit në Djerrinë (steril) (%)	
		K/Pb	K/Zn		Pb	Zn
2019	34,588	793	1,281	32,514	0.20	0.57
2020	25,742	694	1,188	23,860	0.28	0.54
2021	31,068	816	1,656	28,596	0.35	0.51

Flotacioni në Kishnicë dhe Flotacioni në Tunelin e Parë kanë rrjedhje të mëdha të metaleve në steril gjatë procesit të flotimit të xeheve në koncentrate.

Humbje më të mëdha janë identifikuar në Flotacionin në Kishnicë ku gjatë vitit 2019 rrjedhjet e metaleve të Zn arrinin 57%, ndërsa gjatë vitit 2020 dhe 2021 varionin në 54% dhe 51%. Përderisa rrjedhjet e metaleve të Pb kishin trend rritës gjatë viteve 2019-2021, respektivisht nga 20%, 28% dhe deri në 35%.

Flotacioni në Tunelin e Parë gjatë vitit 2019 kishte rrjedhje të metaleve të Zn 40%, me trend rritës gjatë vitit 2020 deri në 43% dhe me një rënie gjatë vitit 2021 në 39%. Kurse rrjedhjet e metaleve të Pb në vitin 2019 ishin 28%, me një ngritje të konsiderueshme gjatë vitit 2019 deri në 35%, dhe me zvogëlim në 30% gjatë vitit 2021. Ndërsa, rrjedhjet e metalit të argjendit gjatë vitit 2021 kishin rezultuar në 6.18%.

Njëkohësisht gjatë fazës së ekzekutimit në terren, ne kemi ekzaminuar edhe linjat e procesit të flotimit në të dyja flotacionet.

Sipas konfirmimeve zyrtare nga Departamenti i Kontrollit të Trepça Sh.A., shkaktari kryesor i rrjedhjes së madhe të metaleve në djerrin (steril) është teknologjia e vjetër me të cilën operojnë flotacionet. Sipas këtij departamenti, deri tek ky konstatim kanë rezultuar nga analizat e shkaqeve të humbjes së metalit të bëra nga ana inxhinierëve të flotacioneve dhe nga ekspertët e angazhuar për këtë çështje. Njëkohësisht, gjatë punës tonë audituese edhe përkundër kërkesave tona tek zyrtarët përgjegjës, nuk kemi arritur të identifikojmë nëse janë vendosur dhe miratuar procedura standarde bashkëkohore të operimit dhe normativa të cilat rregullojnë procesin e flotimit të xeheve në koncentrate.

Rrjedhjet e mëdha të metalit në djerrinë (steril) kanë ndikim direkt në humbjet e kompanisë, duke marrë parasysh se të hyrat nga prodhimi dhe shitjet e kompanisë varen direkt nga përmbajtja e sasisë së metalit në koncentrate.

3.2.3 Mos standardizimi i procesit të punës në flotacione

Standardet lehtësojnë arritjen e cilësisë, unifikojnë procedurat dhe metodat, sipas DS ISO/TR dhe SK ISO⁴⁰ për Miniera dhe Minerale⁴¹. Standardet krijojnë parakushtet e duhura për praktikatat e mira të punës dhe arritjen e realizimit të prodhimit cilësor me metoda bashkëkohore.

Flotacionet e Trepça Sh.A. nuk kanë standardizuar proceset e punës duke adaptuar ISO standardet gjatë procesit të flotimit dhe analizave në laboratorë për kualitetin e xeheve dhe përbërjen e koncentrateve të plumbit dhe zinkut dhe se ende vazhdojnë të operojnë sipas metodave të trashëguara nga sistemi ish Jugosllavisë. Poashtu edhe përkundër kërkesave tona tek zyrtarët përgjegjës gjatë periudhës audituese, nuk kemi arritur të sigurojmë

40. Standarde për sistem cilësor të punës

41. Katalogu i Standardeve Kosovare 2020, Agjencia Kosovare e Standardizimit, MTI

manuale dhe procedura standarde të operimit që rregullojnë në mënyrë të detajuar procesin. Duhet theksuar se gjatë periudhës 2019-2021 Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë – Artanë disa herë i ishte drejtuar laboratorit neutral ndërkombëtarë siç edhe parashihej me marrëveshjet e shitjes në rastet kur ka diferenca jo të pajtueshme mes analizave laboratorike të blerësit dhe shitësit.

Në vazhdim paraqesim numrin e rasteve për analizat e dërguara në laboratorë ndërkombëtarë:

Tabela 5. Rastet për analizat e koncentreve në laboratorë ndërkombëtarë

Viti	NJB Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg			NJB Miniera me Flotacion Trepça Kishnicë - Artanë			Shpenzimet e paguara nga angazhimi i laboratorit ndërkombëtarë
	Nr. i rasteve	Elementet	Nr. rasteve me diferenca negative në faturim ⁴²	Nr. i rasteve	Elementet	Nr. rasteve me diferenca negative në faturim	€
2019	5	Pb & Au & Zn	8	3	Pb & Ag	2	2,935
2020	5	Pb & Au & Zn	-	3	Pb & Ag	-	1,058
2021	9	Pb	1	12	Pb & Zn & Ag	5	6,375
Total	19			18			10,368

Nga të dhënat e prezantuara më lart, shohim se gjatë vitit 2019 divizioni i shitjes ju ka drejtuar laboratorëve neutral ndërkombëtar në 8 raste të mos përputhjes mes blerësit dhe shitësit, në vitin 2020 poashtu 8 raste dhe në vitin 2021 në 21 raste. Shpenzimet e krijuara për tri vite ishin 10,368€.

Rastet e tilla rezultojnë me vonesa në barazim final të faturimit dhe inkasimit të pagesave nga shitjet, penalizime me reduktim të pagesave në rastet e devijimeve të kushteve të kontratave të shitjes lidhur me përbërjen e kualitetit, si dhe shpenzime shtesë për pagesë të procedurave kur rezultatet laboratorike janë në disfavor të Trepça Sh.A. Njëkohësisht mos adaptimi i standardeve dhe procedurave bashkëkohore të operimit krijon mangësi gjatë aktivitetit operativ të kompanisë.

42. Raportet vjetore të divizionit të shitjes dhe qirasë 2019-2021

3.3 Indikatorët e performancës financiare negative

Qëllimi kryesor i NP Trepça Sh.A., është që të jetë profitabile (maksimizoj) profitin.⁴³ Bordi Mbikqyrës përveç kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, ka detyrë dhe përgjegjësi miratimin e raportit vjetor të shoqërisë dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve të cilat pastaj dorëzohen tek aksionarët për miratim.⁴⁴ Pasuria e Trepçës dhe rezultatet e saj financiare paraqiten në pasqyrat e konsoliduara financiare të Trepça Sh.A.⁴⁵

Ne kemi analizuar indikatorët kyç të performancës financiare për periudhën 2018-2021 të cilët janë përmbledhur në tabelën në vazhdim, bazuar në zërat kryesor financiar të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrës së pozitës financiare për Trepça Sh.A.

43. Statuti NP Trepça Sh.A., neni 11, pika 1

44. Statuti NP Trepça Sh.A., neni 19, pika 2

45. Ligji Nr.05/L-120 për Trepçën

Tabela 6. Analizë e indikatorëve të performancës financiare 2018-2021

Vitet	2021		2020		2019		2018		Përshkrimi i indikatorëve
Indikatorët e performancës financiare Trepça Sh.A.	NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë	NJB Kopaonik-Leposaviç	NJB Stan Tërg , NJB Kishnicë-Artanë	NJB Kopaonik-Leposaviç	NJB Stan Tërg , NJB Kishnicë-Artanë	NJB Kopaonik-Leposaviç	NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë	NJB Kopaonik-Leposaviç	
Indikatorët e rentabilitetit									
Marzha e fitimit bruto	16.91	6.08	-78.09	-4.54	83.88	9.10	74.46	11.20	Ky raport tregon se ka pasur kontroll jo të mirë mbi kostot dhe fitimin.
Raporti i fitimit të operimit	-0.05	-0.10	-0.58	-0.23	-0.59	-0.08	-0.73	-0.07	Ky raport tregon se kompania ka profit bruto negativ dhe kosto të larta fikse.
Marzha e fitimit neto	-5.02	-5.82	-58.84	-16.32	-38.28	-6.72	-18.87	8.54	Raporti tregon variacion në profitet/humbjet nga viti në vit, për shkak të shpenzimeve të mëdha.
Raporti i kostos së mallit të shitur	-83.09	-93.92	-178.09	-104.54	-16.12	-90.90	-25.54	-88.80	Raporti tregon për shpenzime të larta në pjesëmarrje të KMSH në raport me të hyrat operative nga shitjet.
Raporti i shpenzimeve operative	-125.43	-13.24	-58.12	-19.87	-196.55	-18.73	-149.65	-19.47	Ky raport është i pafavorshëm sepse tregon se shpenzimet operative janë më të larta në krahasim me të ardhurat.
Indikatorët e likuiditetit									
Raporti aktual-Likuiditeti rrjedhës	1.80	0.68	0.45	0.72	0.45	0.91	0.87	1.04	Ky raport tregon se kompania nuk kishte aftësi të mirë për të përmbushur detyrimet e saj rrjedhëse.

Likuiditeti i shpejtë	0.43	0.45	0.30	0.52	0.45	0.52	0.66	0.62	Ky raport nuk përfaqëson një pozitë të kënaqshme të kompanisë ndër vite.
Raporti i kapitalit punues	0.08	-0.31	(0.06)	(0.25)	(0.02)	(0.07)	-0.03	0.02	Kapitali punues nuk kishte përmirësim të madh ndër vite.
Kapitali punues	15,418,191	(3,766,953)	(9,659,918)	(2,939,373)	3,765,475)	(770,728)	(468,811)	282,479	Kapitali punues është negativ për shkak se detyrimet qarkulluese janë më të mëdha se pasuritë qarkulluese.
Raportet e aktivitetit									
Qarkullimi i stokut	0.54	-4.26	5.52	-5.77	1.02	-8.36	4.05	-15.58	Raport i ulët/negativ i stokut tregon shitjet e ulëta dhe stokun e tepërt.
Qarkullimi i pasurive	0.07	1.03	0.05	1.03	0.06	1.17	0.76	1.13	Shitjet ne raport me total pasurite janë në vlerë të ulët.Një raport i tillë tregon përdorim jo efikas të pasurive fikse si rezultat i kapaciteteve të tepërta dhe furnizimit jo adekuat me lënd të parë.
Raporti i qarkullimit të të arkëtueshmeve	8.11	2.43	4.55	2.37	6.81	3.34	7.81	4.94	Ky raport tregon sa kohë i duhet kompanisë për t'i inkasuar pagesat nga klientet e saj dhe se përgjatë viteve ka shënuar trend rritës.
Qarkullimi i ditëve të llog. të arkëtueshme	44.98	150	108.04	154.31	53.57	109.28	46.71	59.96	Ka pasur rritje të ditëve të llogarive të arkëtueshme marrë parasysh këtu edhe rritjen totale të llogarive të arkëtueshme ndër vite.
Furnizimet e papaguara ditore	135.91	314.54	133.50	258.38	906.00	204.91	285.98	198.44	Raporti tregon për rritje të lart të ditëve për pagesë ndaj furnitorëve dhe vonesa në pagesa të obligimeve.
Raporti borxhit	0.11	0.97	0.12	0.91	0.06	0.73	0.48	0.66	Raporti borxhit kishte trend josignifikant zvogëlimi ndër vite.
Kthimi në pasuri	-0.004	-0.06	-0.03	-0.17	-0.35	-0.08	-0.14	0.01	Kthimi në pasuri ka pasur rënie ndër vite.


Nga këto analiza vërejmë se indikatorët e likuiditetit, rentabilitetit dhe aktivitetit kanë rezultuar me varianca negative të vazhdueshme ndër vite, me theks të veçantë raporti i fitimit të operimit, marzha e fitimit neto, raporti i kostos së mallit të shitur, likuiditeti rrjedhës, likuiditeti i shpejtë dhe treguesit e tjerë që pasqyrojnë rezultatin e operimit me humbje.

Të hyrat dhe shpenzimet

Analizat dhe gjetjet e auditimit lidhur me të hyrat dhe shpenzimet janë paraqitur në vazhdim. Trepça Sh.A nuk aplikon sistem të integruar/konsoliduar të planifikimit dhe raportimit biznesor. Poashtu nuk ka sistem unik të integruar/konsoliduar të raportimit financiar dhe kontabël, përfshirë edhe mos përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara⁴⁶ me të gjitha njësitë e saj biznesore. Planet e Biznesit, Raportet Vjetore si dhe Pasqyrat Financiare Vjetore të Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021⁴⁷ nuk ishin konsoliduar/integruar pasi që nuk përfshihej planifikimi dhe realizimi biznesor, raportimi financiar si dhe pasqyrat financiare, për NJB Kopaonik-Leposaviç, si njësi biznesore sipas Ligjit për Trepça Sh.A. Llogaritë bankare të NJB Kopaonik-Leposaviç menaxhohen ndaras dhe pavarur nga menaxhmenti i Trepça Sh.A. dhe se kjo njësi biznesore poashtu vepron në mënyrë të pavarur në nivel të Trepça Sh.A. dhe për afarizmin e saj nuk raporton tek strukturat e larta menaxhuese të Trepça Sh.A.

Grafiku më poshtë prezanton planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve të Trepça Sh.A për periudhën 2019-2021:

Grafiku 12. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve i integruar për Trepça Sh.A. 2019-2021, '000(€)



46. Ligji për Trepçën 05/L-120 kërkon që Trepça Sh.A. të përgatis pasqyra financiare të konsoliduara si dhe auditimi i tyre. Praktika e deritanishme dëshmon se Auditimi i jashtëm i Pasqyrave financiare vjetore (PFV) të NJB Kopaonik-Leposaviç dhe Pasqyrave financiare vjetore (PFV) të NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, bëhet duke kontraktuar ndaras kompani audituese dhe referuar raporteve të auditimit për disa vite rradhazi opinionet e auditimit për këto pasqyra janë kualifikuar apo mohuar.

47. Planet e Biznesit për vitet 2019-2021, NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe NJB Kopaonik-Leposaviç

Në vazhdim paraqesim shpalosjen e të hyrave dhe shpenzimeve sipas njësive biznesore,⁴⁸:

Njësitë biznesore **Metalurgjia e Zinkut dhe Energjetika** janë njësi jo produktive të cilat nuk gjenerojnë të hyra mirëpo vetëm krijojnë shpenzime. **Industria Kimike** nuk operon me kapacitete të plota, në të kaluarën prodhonte kryesisht acid sulfurik, superfosfat, sulfat alumini dhe plehëra artificiale si (NPK-a). Prodhimi aktual është kufizuar vetëm në një sasi të vogël sulfat alumini për impiantet e trajtimit të ujit. Ndërsa planifikon të hyra edhe nga qiratë e objekteve. Të gjitha repartet tjera janë jashtë funksionimit. **Fabrika e Pajimeve të Procesit**, gjatë viteve të '80 është marrë me prodhimin masiv të rimorkiove ndërsa sot prodhon në baza minimale bazuar vetëm në kërkesat e tregut. Aktualisht aktivitet kryesor e ka mirëmbajtjen e kapaciteteve aktuale prodhuese të Trepçës, ku kryejnë shërbime riparimi të pajisjeve të dëmtuara për minierat dhe flotacionet. Ndërsa planifikon gjenerimin e të hyrave nga shërbimet e shitjes se pjesëve të imta rezervë, si dhe nga qiratë e objekteve. **Fabrika e Akumulatorëve** në të kaluarën ka prodhuar akumulatorë, bateri stacionare, bateri të motoçikletave. Ndërsa aktualisht të gjitha repartet e kësaj njësie biznesore janë jashtë prodhimit. Për momentin stafi i kësaj NJB janë të angazhuar në mirëmbajtjen e fabrikës, ndërsa të hyrat i planifikon vetëm nga qiratë e objekteve. **Stabilimentet Energjetike (Energjetika)**, kjo njësi biznesore krijon vetëm shpenzime të mirëmbajtjes së stabilimenteve elektrike dhe se aktualisht furnizon me energji elektrike minierën e Stan Tërgut, Flotacionin Tuneli i Parë dhe njësitë biznesore që gjenden në PIM (Parku Industrial Mitrovicë).

Tabela në vazhdim pasqyron nivelin e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve në valutën euro bazuar në raportet vjetore dhe pasqyrat financiare⁴⁹ të Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021, ndërsa për qëllime krahasimore kemi përfshirë edhe vitin 2018:

48. Planifikimi i të hyrave nga shitja e mbetjeve industriale sipas Plan Biznesit Trepça Sh.A. NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë për vitin 2020 ishte në total 8,050,000€ (Mbetjet industriale Kishnicë: 7,550,000€ dhe Mbetje industriale Zveçan: 500,000€), ndërsa në Raportin Vjetor të vitit 2020 nuk ishin përfshirë në raportim të realizimit të të hyrave. Për vitin 2021 sipas Planit Biznesit fillestar, të hyrat e planifikuara nga shitja e mbetjeve industriale ishin në total 4,446,430€ (Të hyrat nga shitja e mbetjeve Artanë: 764,970€, Të hyrat nga shitja e mbetjeve (fërgesa e piritit dhe pirotinës) :45,900€, Të hyrat nga shitja e mbetjeve (jarositi): 385,560€, Të hyrat nga shitja e mbetjeve (fosfogjipsi): 1,250,000€. Ndërsa në Plan Biznesin e rishikuar për vitin 2021, të hyrat nga shitja e mbetjeve industriale nuk ishin përfshirë.

49. Sipas pasqyrave të ndara të të ardhurave gjithëpërfshirëse të NJB Trepça Sh.A. për periudhën 2018-2021

Tabela 7. Zërat bilancor të integruar nga pasqyrat e të ardhurave⁵⁰ gjithëpërfshirës⁵¹ të NJB Trepça Sh.A., 2018-2021

Trepça Sh.A	2021(€)	2020(€)	2019(€)	2018(€)	Total
Të hyrat operative nga shitjet	26,095,748	20,152,835	22,216,501	24,674,727	93,139,811
Kosto e shitjes	(23,022,560)	(26,979,662)	(13,422,482)	(14,498,869)	(77,923,573)
Fitimi/(humbja) bruto	3,073,188	(6,826,827)	8,794,019	10,175,858	15,216,238
Të hyrat tjera	7,394,201	7,085,933	3,590,131	491,515	18,561,780
Shpenzimet operative dhe tjera	(19,386,714)	(7,674,054)	(20,265,184)	(20,058,379)	(67,384,331)
Fitimi/(humbja) operative	(8,919,325)	(7,414,948)	(7,881,034)	(9,391,006)	(33,606,313)
Shpenzimet financiare	(32,312)	(106,340)	(90,856)	(72,031)	(301,539)
Të ardhurat financiare	553,246	813,804	5,212,171	4,268,415	10,847,636
EBIT Fitimi/(humbja) para tatimit	(8,398,391)	(6,707,484)	(2,759,719)	(5,194,622)	(23,060,216)
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-	-	-	-
Fitimi/(humbja) neto e vitit	(8,398,391)	(6,707,484)	(2,759,719)	(5,194,622)	(23,060,216)
Të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit	(8,398,391)	(6,707,484)	(2,759,719)	(5,194,622)	(23,060,216)

Të dhënat e paraqitura më lart tregojnë se Trepça Sh.A⁵². nuk kishte realizuar të hyrat sipas planeve të biznesit për periudhën 2019-2021, ku të hyra të planifikuara ishin 127,684,846€ ndërsa realizimi 93,114,570€ apo 73%. Realizimi i të hyrave sipas viteve ishte: për vitin 2019 të hyra të realizuara në total 69.8%, në vitin 2020 65% ndërsa në vitin 2021 të hyrat e realizuara në total ishin 85%. Kjo si rezultat i mos realizimit të të hyrave operative nga shitjet e koncentratit të plumbit dhe zinkut dhe të hyrat tjera.

50. Në PFV të Trepça Sh.A. nuk ishin shpalosur të hyrat dhe shpenzimet e gjeneruara sipas njësive biznesore të Trepça Sh.A.

51. Në listën e pensioneve janë ish-punëtorë të Trepça Sh.A të cilët nuk e kanë plotësuar moshën e pensionimit (65 vjeç) dhe nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune në Trepça Sh.A. Në listën e stipendioneve janë ish-punëtor të Trepça Sh.A të cilët për shkaqe shëndetësore nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune në Trepça Sh.A.

52. Së fundmi, nga ri-funksionalizimi i Terminalit Doganor specifikisht përmes vendosjes së Zyrës së Brendshme Doganore (ZBD) në hapësirën e brendshme të Trepça Sh.A. në (PIM) Mitrovicë, Trepça realizon të hyra nga taksa/tarifa nga qarkullimi i automjeteve në zyrën e mbledhjes së taksave, për mallrat të cilat i nënshtrohen procedurave doganore të zhdoganimit të mallrave. Marrëveshja e dt. 15/10/2021 mbi Vendosjen e Zyrës së Brendshme Doganore në hapësirën e Trepça Sh.A. Mitrovicë, nënshkruar në mes të Trepça Sh.A. dhe Dogana e Kosovës, ndërsa në fuqi nga dt. 18/10/2021

Realizimi i të hyrave sipas njësive biznesore të Trepça Sh.A. është si vijon: nga NJB Stan Tërg për vitin 2019 ishte 6,906,275€ apo vetëm 45%, nga NJB Kishnicë-Artanë 1,890,791€ apo vetëm 41%, nga Industria Kimike 114,076€ apo 41%, nga Fabrika e Akumulatorëve Mitrovicë 50,952€ apo 33%, nga Fabrika e Pajisjeve të Procesit 21,654€ apo 6%, të hyrat nga shitja e mbetjeve industriale 147,058€, të hyra tjera 203,368€, subvencione nga buxheti i Kosovës 4,153,968€; realizimi i të hyrave për vitin 2020 nga NJB Stan Tërg ishte 6,243,358 apo 58%, nga NJB Kishnicë-Artanë 1,598,916 apo vetëm 37%, nga Industria Kimike 132,019€ apo 45%, nga Fabrika e Akumulatorëve Mitrovicë 39,266€, nga Fabrika e Pajisjeve të Procesit 20,786€ apo 86%, të hyra tjera 121,397€, subvencione nga buxheti i Kosovës 7,212,202€, nga NJB Kopaonik-Leposaviç për vitin 2019 ishin realizuar të hyrat 13,394,609€ apo 74%, për vitin 2020 12,873,416€ apo 83%, dhe për vitin 2021 12,568,189€ apo 77%, dhe kjo si rezultat i zvogëlimit të të hyrave operative nga shitjet, ndërsa të hyrat e njohura nga kjo njësi biznesore për subvencionet nga buxheti i Kosovës për vitin 2018 ishin 924,861€, për vitin 2020 630,560€ dhe për vitin 2021 330,306€.

Nga sa u theksua më lart, qarkullimi gjatë viteve për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe njësi tjera, ka pasur varianca të mëdha me ngritje/rënie. Me theks të veçantë në vitin 2021 që kishte shënuar ngritje prej 46% në krahasim me vitin 2020. Kjo si rezultat i rritjes së shitjeve të prodhimit, ngritjes së çmimeve të metaleve në berzë LME dhe subvencionimit nga aksionari- Qeveria e Kosovës për paga dhe investime kapitale. Ndërsa të hyrat operative nga shitjet për NJB Kopaonik-Leposaviç kishin shënuar rënie graduale nga viti 2019 deri në vitin 2021, duke përfshirë edhe të hyrat tjera si dhe qarkullimi nëpër vite ka shënuar ngritje apo rënie të lehtë varësisht sipas faktorit të çmimit dhe sasisë të shitjes së prodhimit, përfshirë edhe subvencionimin.

Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021 ka planifikuar shpenzime 106,440,122€ ndërsa shpenzime të realizuara për po të njëjtën periudhë ishin 110,980,164€ me tejkalim nga planifikimi prej 4,540,042€. Shpenzimet operative kanë shënuar rritje nga viti në vit, me theks në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020, si rezultat i ngritjes së çmimeve për lëndë të parë, materialit, dhe energjisë elektrike, përfshirë edhe ndikimin e pandemisë globale COVID-19.

Humbja për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë ka pasur trend rritës deri në vitin 2020, ndërsa në fund të vitit 2021 ishte zvogëluar dukshëm mirëpo edhe përkundër zvogëlimit viti financiar është përmbyllur me rezultat negativ 689,468 €⁵³, ndërsa humbja e akumuluar deri me dt. 31/12/2021 ishte 23,627,433 €⁵⁴.

Trendi i operimit me humbje për NJB Kopaonik-Leposaviç ishte evident edhe për vitin 2021 me rezultat negativ 719,820€, si vazhdimësi nga dy vitet paraprake, por me një zvogëlim të theksuar ndërsa humbja e akumuluar për këtë njësi deri me dt. 31/12/2021 ishte 2,416,724 €⁵⁵.

53. Kompania kishte ndërmarrë korrigjim tek zëri stokeve.

54. Raporti i auditorit të pavarur për PFV 2021 NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë


55. Raporti i auditorit të pavarur për PFV 2021 NJB Kopaonik-Leposaviç

Ndikimi i lart në humbje është si shkak i shpenzimeve të larta operative që tejkalojnë të hyrat, me theks dominojnë shpenzimet e larta për paga dhe shtesat në paga të punëtorëve ku vetëm shpenzime të realizuara për paga dhe shtesa për periudhën 2018-2021 ishin 34,263,165€, përfshirë dhe shpenzimet nga njësitë jo profitabile. Tek shpenzimet duhet vënë në pah se Trepça Sh.A. ka krijuar shpenzime për njësinë Fabrika e Municionit dhe Gjetisë, fabrikë kjo e cila nuk është njësi biznesore e Trepça Sh.A. sipas statutit dhe ligjit.

Referuar analizave dhe vlerësimeve të Trepça Sh.A.⁵⁶ për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, humbja mesatare mujore e kësaj njësie organizative arrin 620,307€. Kjo si rrjedhojë se shpenzimet e përgjithshme mesatare mujore tejkalojnë të hyrat mesatare mujore të realizuara nga shitja, dhe referuar këtij plani për të mbuluar humbjet dhe arritur pikën e rentabilitetit duhet realizuar shitje prej 1,600.13 ton koncentrat (553.21 K/Pb & 1,046.92 K/Zn).Pra, kjo sasi koncentratit nënkupton pragun e rentabilitetit në Trepça Sh.A.

Diferencat nga kursi i këmbimit valutor ishin negative për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë për vitet 2019-2021, ndërsa për NJB Kopaonik-Leposaviç diferenca pozitive e kursit të këmbimit kishte rezultuar për vitin 2019 dhe 2021 ndërsa për vitin 2020 ishte negative. Këto diferenca kanë rezultuar në shpenzime dhe kanë ndikuar në rezultatin financiar të kompanisë. Diferencat nga këmbimi i kursit valutor USD/Euro i paraqesim në vijim përmes grafikut në vijim:

Grafiku 13. Diferencat nga kursi i këmbimit valutor USD/Euro, 2019-2021




56. Planit Emergjent për dalje aktuale nga kriza financiare në Trepça Sh.A. i dt. 12/01/2022 të përgatitur nga Ud. KE

3.3.1 Shpenzimet e larta të prodhimit dhe kosto e mallit të shitur

Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për vendosjen e kontrollit të brendshëm në ndërmarrjen⁵⁷ publike si dhe delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike. Plani i Biznesit duhet të analizojë përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës për financimin e shpenzimeve si dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve.⁵⁸

Realizimin për koston e mallit të shitur nga Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021 e prezantojmë në vijim:

Grafiku 14. Realizimi për KMSH, ('000 Euro)



Kosto e mallit të shitur të realizuar për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë nga viti 2019 (1,459,957€) në vitin 2020 (14,316,552€) ishte rritur dukshëm me diferencë prej 12,856,595€, ndërsa kishte një zvogëlim të lehtë gjatë vitit 2021(11,402,151€) me diferencë nga viti paraprak prej 2,914,401€.

Pjesëmarrjen më të lart në kostot e shitjes për vitin 2021 e përbëjnë pagat e punëtorëve në prodhim me 6,409,033€, shpenzimet e energjisë elektrike me 2,501,636€, shpenzimet e rentës minerare me 656,673€, materialet me 657,513€, eksplozivi me 457,763€ (viti 2020:408,314€), ndërsa zërat tjerë kanë pjesëmarrje të përbashkët 3% duke përfshirë edhe shpenzimet për reagensa 503,748€. Krahasuar me vitin 2020, pjesëmarrjen më të lart poashtu e përbënin pagat e punëtorëve në prodhim me 10,403,507€, energjia elektrike në prodhim me 1,140,034€, materialet me 1,110,075€, eksplozivi me 408,314€, shpenzimet e rentës minerare me 690,176€, dhe zërat tjerë me pjesëmarrje të përbashkët 4% duke përfshirë shpenzimet për reagensa 434,165€. Shpenzimet e pagave ishin zvogëluar gjatë vitit 2021 si rrjedhojë e ndalesave në disa shtesa për pagat e punëtorëve në prodhim.

57. Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 10

58. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 30

Me përjashtim të zërit materiale i cili kishte rënie të dukshme prej 69% nga viti 2020 në vitin 2021, apo shprehur në shumë 452,562€. Duhet theksuar se ndikim tek shpenzimet e larta kanë edhe mungesa e rregulloreve për pagat dhe shpenzimet tjera të cilat do të klasifikonin shpenzimet e shitjes, nivelizonin shpenzimet dhe pagesat shtesë, shpenzimet e mirëmbajtjes së teknologjisë së vjetërsuar, nivelet e larta të përdorimit të reagensëve dhe të tjera.

Kosto e mallit të shitur e prezantuar për NJB Kopaonik-Leposaviç kishte shënuar trend rritës nga viti 2019 (11,962,525€) në vitin 2020 (12,663,110€) dhe rënie gjatë vitit 2021 (11,620,409€). Diferenca rritëse prej vitit 2019 në vitin 2020 ishte 700,585€, ndërsa nga viti 2020 në vitin 2021 zvogëlim prej 1,042,701€, si rezultat i mos realizimit të plotë të punëve në prodhim të nën kontraktuara nga operatori ekonomik i jashtëm. Pjesëmarrjen më të lart në kostot e shitjes përgjatë viteve e kishte zëri i pagave të punëtorëve me 7,199,709€ në vitin 2019, me 8,163,825€ në vitin 2020 dhe me 8,589,238€ në vitin 2021, pasuar nga shpenzimet për repromaterial me 2,606,092€ për vitin 2019, 2,949,676€ për vitin 2020 dhe me rënie në vitin 2021 prej 22% apo 2,504,474€. Shpenzimet tjera direkte kishin shënuar rënie gjatë vitit 2021 me 5% poashtu si shkak i mos realizimit të plotë të kontratës për punët e kontraktuara në prodhim.

Shpenzimet e detajuara direkte të prodhimit të shpalosura për njësitë biznesore prodhuese janë bashkangjitur në Shtojcën II tabela 23.

Diferencat e mëdha të rritjes së shpenzimeve me theks të veçantë gjatë vitit 2020 u ndikuan edhe nga kriza e pandemisë Covid-19 ku çmimet e lëndës së parë prodhuese kishin shënuar ngritje. Poashtu shpenzimet e energjisë elektrike ishin rritur dukshëm në vitin 2021 si shkak i krizës energjetike dhe ngritjes së çmimeve, dhe në përgjithësi shpenzimet nëpër zërat e prezantuar më lart kishin ngritje gjatë vitit 2021 si rezultat i ngritjes së lehtë të nivelit prodhues. Ndërsa shpenzimet e pagave ishin rritur si rezultat i punësimit të stafit të ri në prodhim dhe paralel edhe shtesat dhe stimulimet tjera në paga që aplikohen për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë.

Shpenzimet e larta në përgjithësi krijojnë vështirësi në operimin e kompanisë si dhe tejkalimi i tyre ndikon edhe në zvogëlimin e rezultatit financiar të kompanisë.

Pasuritë dhe detyrimet

Analizat e zërave financiar të integruar për pasuritë dhe detyrimet nga pasqyra e pozicionit financiar për Trepça Sh.A. të prezantuar në tabelën më poshtë, tregon rritje ndër vite të aseteve, kapitalit dhe detyrimeve. Me theks të veçantë, rritja e vlerës së aseteve nga viti 2020 në vitin 2021 ishte 16%, rritja e vlerës së ekuitetit dhe detyrimeve ishte 12%. Rritja e vlerës së aseteve ndër vite ishte rezultat i mos prezantimit të gjithë pasurisë jo qarkulluese në pasqyra financiare, poashtu ndikim kishte edhe rritja e llogarive të arkëtueshme ndërsa rrjedha e parasë së gatshme kishte trend zvogëlimi

gjatë viteve. Ndikim në rritjen e ekuitetit ishte humbja e akumuluar përgjatë viteve dhe mos prezantimi i saktë dhe drejtë i kapitalit ndër vite. Ndërsa rritja e detyrimeve ishte si rezultat i rritjes së detyrimeve qarkulluese të vitit si shkak i mungesës së likuiditetit për përmbushje të obligimeve afatshkurtëra ndaj operatorëve dhe furnizuesve të kompanisë si dhe obligimeve tjera.

Në vijim janë prezantuar të integruar zërat financiar të pasurisë dhe detyrimeve nga pasqyra e pozicionit financiar Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë, NJB Kopaonik-Leposaviç dhe të tjera njësi:

Tabela 8. Zërat bilancor të pozicionit financiar të integruar Trepça Sh.A ⁵⁹, 2018-2021

Trepça Sh.A	2021(€)	2020(€)	2019(€)	2018(€)
Asetet joqarkulluese	154,042,422	154,240,793	154,441,607	15,998,407
Asetet qarkulluese	42,689,071	15,602,202	10,484,955	10,819,183
Rrjedha e parasë së gatshme	1,007,718	616,472	342,506	3,899,843
Gjithsejt asetet	197,739,211	170,459,467	165,269,068	30,717,433
Kapitali aksionar	190,215,350	165,820,443	163,058,866	22,808,174
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(24,634,869)	(17,927,386)	(10,815,331)	(8,715,471)
Gjithsejt ekuiteti	165,580,481	147,893,057	152,243,535	14,092,703
Detyrimet joqarkulluese	1,522,466	1,003,082	2,012,346	3,799,232
Detyrimet qarkulluese	31,037,833	28,201,493	15,021,158	11,005,515
Gjithsejt detyrimet	32,560,299	29,204,575	17,033,504	14,804,747

59. Në PFV nuk ishin shpalosur pasuritë dhe detyrimet sipas njësive biznesore të Trepça Sh.A.

Gjithsejt asetet⁶⁰, kapitali dhe detyrimet e prezentuara për njësitë biznesore Stan Tërg dhe Kishnicë- Artan, për vitin 2018: asete (15,366,399 €), kapitali (8,067,150€), detyrimet (7,299,249€), për vitin 2019: asete (153,673,875 €), kapitali (144,851,158 €), detyrimet (8,822,717 €), për vitin 2020: asete (158,650,566€), kapitali (140,120,901€), detyrimet (18,529,665€), për vitin 2021: asete (184,669,173€), kapitali (163,826,340€), detyrimet (20,842,832€); për njësinë biznesore Kopaonik-Leposaviç për vitin 2018: asete (11,431,191€), kapitali (3,925,693€), detyrimet (7,505,498€), për vitin 2019: asete (11,252,687€), kapitali (3,041,899€), detyrimet (8,210,787€), për vitin 2020: asete (11,739,582€), kapitali (1,064,673€), detyrimet (10,674,910€), për vitin 2021: asete (12,062,321€), kapitali (344,853€), detyrimet (11,717,467€).

Rrjedha e parasë së gatshme për njësinë biznesore Stan Tërg, Kishnicë-Artanë dhe njësi tjera , përgjatë viteve 2018-2021 ishte mjaft e ulët me më pak se një milion euro: viti 2018 (793,194€), 2019 (37,236€), 2020(197,189€), 2021(847,175€), për NJB Kopaonik-Leposaviç për vitin 2018 (3,106,649€), viti 2019 (305,270€), viti 2020 (419,283€), viti 2021(133,543€).

Lidhur me zërin financiar asetet jo qarkulluese, vërejmë varianca të mëdha nga viti në vit me theks të veçantë duke filluar nga viti 2018 dhe prezantimet në vitet pasuese, ndërsa rritja e saldos së neto aseteve nëpër vite për NJB Kopaonik-Leposaviç ishte si rrjedhojë e investimeve kapitale. Përderisa, për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe njësi tjera, regjistri i aseteve mbahej në formatin excel, ka pasiguri materiale rreth shumave të prezantuara në pasqyra financiare përfshirë politikat dhe metodat jo konsistente të aplikimit të zhvlerësimit.

Në kuadër të zërit financiar të pasurisë, nuk ishin evidentuar si asete deri në vitin 2021, mbetjet minerare dhe metalurgjike në sasi prej rreth 60 milionë tonelata dhe që përfshijnë sipërfaqe prej rreth 200 hektarësh të cilat i prezantojmë më poshtë:

60. Regjistri i aseteve mbahet në excel dhe se jo në softuer të kontabilitetit Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe njësi tjera biznesore, njëkohësisht ka pasiguri materiale rreth mbajtjes së evidencës kontabël dhe raportimit financiar pasi nuk gjenerohet libri kryesor sipas kërkesave të standardeve, poashtu nuk janë integruar në softuer të gjitha modulet. Ndërsa, NJB Kopaonik-Leposaviç mban evidenca kontabël dhe financiare ndaras në nivel të Trepça Sh.A.

Tabela 9. Tabela e deponive të mbetjeve industriale të Trepçës⁶¹

Nr.	Vendi	Emri i depozitit	Materiali	Aktive ose braktisur	Sipër- (ha)	Pesha (t)
1	Leposaviç	Gornji Kmjin	Fundërrinë	Braktisur	6.5	2.6x10 ²
2	Leposaviç	Bostanishte	Fundërrinë	Aktive	10-Aug	3.6x10 ⁶
3	Zveçan	Zhitkovc	Fundërrinë	Braktisur	26	8.5x10 ⁶
4	Zveçan / Mitrovicë	Gornje Pole	Fundërrinë	Braktisur	50	12x10 ⁶
5	Tunel Parë	Zarkov Potok	Fundërrinë	Aktive	12-Aug	3.6x10 ⁶
6	Gračanicë	Staro Jaloviste	Fundërrinë	Braktisur	40	11x10 ⁶
7	Badovc	Badovc	Fundërrinë	Aktive	18	7.7x10 ⁶
8	Artanë	Artanë	Fundërrinë	Braktisur	4	1,8x10 ⁶
9	Zveçan / Mitrovicë	Gornje Pole	Zgjyrë pb.	Braktisur	6-Apr	2.5x10 ³
10	Zveçan	Depozit hiri	Hi	Braktisur	15- Oct	10x10 ³
11	Mitrovicë	PIM depozitë	Gjips	Braktisur	10	4x10 ⁵
12	Mitrovicë	PIM depozitë	Oksid Fe	Braktisur	9	5x10 ⁵
13		PIM depozitë	EM CO-Fund	Braktisur	10	5x10 ⁵
14		PIM depozitë	Jarosit	Jo Aktive	5,4	1.2x10 ⁵

Sipas plan biznesit të Trepça Sh.A. nuk ishte paraparë ndonjë studim apo analizë e jashtme rreth vlerës aktuale të këtyre mbetjeve të cilat do të mund të gjeneronin të hyra në bazë të vlerës reale të tregut, edhe pse një sasi e tyre ishte shitur gjatë periudhës paraprake përfshirë vitin 2019 me aprovim të Bordit Mbikëqyrës. Njëkohësisht, rivlerësimi i aseteve për Trepça Sh.A nuk është kryer asnjëherë deri me dt. 31/12/2021, i cili do të mundësonte në paraqitjen reale, të saktë dhe të drejtë të gjendjes dhe vlerës së pasurisë, edhe pse Trepça Sh.A. me plan biznesi kishte paraparë kryerjen e rivlerësimit mirëpo i cili nuk është realizuar si shkak i gjendjes së rënduar financiare.

61. Deponitë e mbetjeve minerare dhe metalurgjike të Trepça Sh.A. dhe mundësia e valorizimit të tyre, Raport i Trepça Sh.A. i dt. 03/12/2021

3.3.2 Obligime të larta ndaj furnitorëve të lëndës së parë në prodhim dhe të tjera

Trepça Sh.A. të paktën një (1) herë në vit duhet të verifikojë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.⁶²

Obligimet ndaj furnitorëve të lëndës së parë në prodhim si dhe obligimet tjera kishin shënuar trend rritës nga viti në vit për Trepça Sh.A. Pasqyrimi i obligimeve është prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela 10. Pasqyra e integruar e obligimeve të Trepça Sh.A. për periudhën 2018-2021⁶³

Trepça Sh.A.	2021(€)	2020(€)	2019(€)	2018(€)
Detyrimet për rentën minerare	8,212,375	7,545,927	797,642	171,446
Pagat e pagueshme	1,357,263	1,545,367	249,028	532,252
Tatimi në paga i pagueshëm dhe kontribute	8,982,957	5,482,211	2,379,772	1,090,526
Llogaritë e pagueshme / Furnitorët	8,973,772	10,217,141	7,808,334	6,548,034
Detyrimet tjera për furnitorë-TVSH	1,151,988	1,160,408	1,151,922	1,363,709
Detyrime tjera afatsh-kurtëra	633,234	539,693	212,694	-
Detyrime për tender	22,728	-	59,772	49,616
Të hyrat e shtyera	-	-	866,846	-
Total detyrimet afatshkurtëra	29,334,317	26,490,747	13,526,010	9,755,583
Të hyrat e shtyera -grantet	3,225,981	2,713,827	3,507,495	5,049,164
Total detyrimet	32,560,298	29,204,574	17,033,505	14,804,747

62. Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, pika 1 dhe 2

63. Në zërin financiar të obligimeve janë përfshirë edhe obligime të bartura nga periudha kur Trepça ishte NSH nën administrimin e AKP-së.

Obligimet e Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë -Artanë si dhe njësitë tjera, nga viti 2018 (7,299,249€) në vitin 2019(8,822,717€) kishin shënuar rritje prej 17%, në vitin 2020 (18,529,665€) me rritje prej 52% dhe respektivisht në vitin 2021(20,842,832€) rritje prej 11%. Për vitin fiskal/përmbyllës 2021, me pjesëmarrje më të lart ishin detyrimet për rentën minerare ndaj KPMM me 43%. Ndërsa trendi në rritje i obligimeve përgjatë viteve kishte vazhduar edhe për NJB Kopaonik-Leposaviç ku nga viti 2018 (7,505,498€) në vitin 2019 (8,210,788€) rritja ishte 9%, dhe se për vitin 2020 (10,674,909€) dhe 2021 (11,717,466€), rritja ishte 23% dhe respektivisht 9%. Për vitin fiskal/ përmbyllës 2021, me pjesëmarrje më të lart ishin obligimet e pagueshme vendore me 47% dhe detyrimet ndaj punëtorëve për tatim në paga dhe kontribute pensionale me 36%. Detyrimet e NJB Kopaonik-Leposaviç ndaj KPMM për rentën minerare për vitin fiskal/ përmbyllës 2021 ishin 230,586€.

Për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, gjatë periudhës 2019-2021 janë lidhur kontrata për furnizim me lëndë të parë prodhimi në shumë 3,868,806€, të cilat i kemi paraqitur të detajuara në Shtojcën II të raportit, tabela 24. Ndërsa, për NJB Kopaonik-Leposaviç janë lidhur kontrata për furnizim me lëndë të parë gjatë tri viteve në shumë të përbashkët 6,823,589€ (Shtojca II e raportit, tabela 24.1.), si dhe kontrata për punët e kontraktuara në prodhim 3,174,830€ (Shtojca II e raportit, tabela 24.2). Duhet theksuar se për NJB Kopaonik-Leposaviç , kontratat për furnizime me operatorë ekonomik nuk janë lidhur nga Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A., mirëpo nga Drejtori Gjeneral apo/dhe Zyrtari i Prokurimit i NJB Kopaonik-Leposaviç.

Obligimet e bartura të NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë ndaj operatorëve ekonomik për këto furnizime si dhe obligime të tjera i kemi paraqitur në formë tabelare në vazhdim:

Tabela 11. Obligimet ndaj OE për lëndë të parë prodhimi dhe obligime tjera

Obligimet ndaj Operatorëve Ekonomik për furnizim me lëndë të parë dhe obligime tjera (€)	2021	2020	2019
Lëndë të parë prodhimi	831,856	515,525	355,307
Parapagimet ndaj OE për furnizim me lëndë të parë prodhimi	13,840	18,200	-
Energji elektrike	711,766	2,154,255	838,240
Furnizim me hi fluturues dhe bartjes së hirit	1,269,246	1,500,169	1,585,471
Ushqim të punëtorëve në prodhim	173,603	118,530	138,855
Transport të punëtorëve në prodhim	53,181	39,935	63,229
Transport të xehes	103,803	81,678	71,461
Impiante dhe makineri tjera	8,403	70,887	10,514
Pjesë rezervë për pompën e hidrombushjes	113,495	43,045	55,045
Furnizim me ujë	193,709	111,072	74,392
Sigurime shëndetësore për punëtorët ndaj aksidenteve në punë	111,320	58,583	70,957
Vaj dhe yndyrna	99,303	96,948	49
Bartjen e mbeturinave	6,745	9,173	6,490
Obligimet tjera të bartura ndër vite	118,028	236,057	236,057
Obligimet ndaj Administratës Tatimore deri me dt.31/12/2021	8,473,431⁶⁴		

Nga tabela më lart, shohim se në fund të vitit 2019 shuma e obligimeve ndaj furnitorëve të lëndës së parë në prodhim kishte shënuar trend rritës ku për periudhën krahasuese 2019-2020 kishte rritje prej 45%, ndërsa gjatë periudhës 2020-2021 ishte 61%.

Në pamundësi të pagesës së të gjitha obligimeve rrjedhëse si pasojë e operimit me humbje dhe mungesës së likuiditetit dhe respektivisht rentabilitetit, Trepça në vazhdimësi ishte subvencionuar nga aksionari përmes marrëveshjeve të subvencionimit. dhe të cilat i paraqesim në vijim me theks për vitin 2021:

64. Obligimet për tatim në paga (3,318,042 Euro) dhe për kontribute pensionale (5,155,389 Euro) me dt. 31/12/2021 për Trepça Sh.A., sipas letër konfirmimit të pranuar nga ATK të dt.28/02/2022. Deklarimet tatimore sipas numrit fiskal TREPÇA -NDËRRMARRJE NË ADMINISTRIM TË AKP N.SH. Deklarimet tatimore për Trepça Sh.A. bëhen përmes një numri unik fiskal dhe të TVSH-së.

Marrëveshje e monitorimit dhe kontrollit me NJPMNP⁶⁵ për subvencione për mbulimin e një pjesë të obligimeve tatimore ndaj ATK-së, që të mos rrezikohet leja e punës për flotacion nga KPMM. Paga fillestare prej 860,000 € ishte transferuar tek ATK gjatë periudhës janar 2022 bazuar në marrëveshjen⁶⁶, ku parashihet që Trepça Sh.A. të kryej pagesa periodike mujore të rregullta në shumë 290,000€⁶⁷ me kohëzgjatje 36 periudha/muaj.

Marrëveshje monitorimi dhe kontrolli me NJPMNP⁶⁸ për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve operative në shumë 955,471€, ku ishin kryer pagesa ndaj obligimeve për energji elektrike dhe një pjesë për obligimet e ushqimit të punëtorëve. Këto pagesa ishin transferuar tek operatorët gjatë periudhës dhjetor, 2021. Marrëveshja e monitorimit dhe kontrollit me NJPMNP⁶⁹ për subvencionimin e shpenzimeve operative në shumë 3,000,000€, të cilat ishin shfrytëzuar në dhjetor 2021 për pagesë poashtu të obligimeve për energji elektrike.

Duhet theksuar se Trepça Sh.A. gjatë vitit 2020 kishte lidhur marrëveshje me procedurë përbarimore për pagesë me këste të obligimeve ndaj KEK Sh.A. për furnizim me hi fluturues dhe bartje të hirit, ku deri në përmbyllje të vitit 2020 ishin paraparë pagesa mujore në shumë 10,000€, ndërsa nga viti 2021 pagesa periodike mujore në shumë 20,000€. Trepça Sh.A. nuk kishte arritur t'i përmbahej kësaj marrëveshje për pagesa të rregullta.

Trendi rritës i obligimeve ndër vite ka ndodhur si rrjedhojë e gjendjes së rënduar financiare dhe pamundësisë së pagesave, si dhe mungesës së planit për prioritizim të pagesave ndaj furnitorëve.

Trendi rritës i obligimeve rrezikon ballafaqimin e kompanisë me konteste gjyqësore dhe përbarimore dhe rrjedhimisht edhe me shpenzime shtesë, si rezultat i mos përmbushjes me kohë të pagesave sipas kushteve kontraktuale me furnitorët. Për më tepër, vonesat në pagesa rrezikojnë ndërprerjen me furnizim me lëndë të parë dhe për pasojë edhe procesin e prodhimit.

65. Marrëveshja nr. 3317 e dt. 31/12/2021

66. Marrëveshje nr.15723 të dt. 18/01/2022 mes Trepça Sh.A. dhe ATK për pagesë me këste të obligimeve

67. Kësti mujor prej 290,000€ përfshinë tatimin bazë, ndëshkimet dhe interesat e akumuluar. Sipas orarit të marrëveshjes për pagesë, të dt. 18/01/2022 , bilanci tatimor ishte 7.839,319€, bilanci i interesit ishte 730,440€, dhe bilanci i ndëshkimit 710,773€.Pagesat totale të marrëveshjes : 10,972,127€.

68. Marrëveshja nr. 5627

69. Marrëveshja nr. 3309

3.3.3 Trendi i rritjes ndër vite për të arkëtueshmet

Trepça Sh.A. të paktën një (1) herë në vit duhet të verifikojë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.⁷⁰

Trendi në rritje i llogarive të arkëtueshme ishte theksuar dukshëm gjatë viteve 2018-2021. Shpalosjen e tyre në nivel të Trepça Sh.A. e kemi prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela 12. Pasqyra e integruar e të arkëtueshmeve Trepça Sh.A. për periudhën 2018-2021⁷¹

Trepça Sh.A.	2021(€)	2020(€)	2019(€)	2018(€)
Të arkëtueshmet tregtare vendore	2,401,003	2,504,076	1,841,561	1,624,929
Provizione për borgje të këqija	(110,590)	(110,590)	(110,590)	(107,328)
Kërkesa për TVSH	4,999,730	3,758,133	2,530,583	2,230,853
Avanset	5,000	406,505	10,722	
Kërkesa tjera	753,802	942,644	997,084	272,386
Total	8,048,945	7,500,768	5,269,360	4,120,840

Të arkëtueshmet e Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë -Artanë nga viti 2018 (1,499,657€) në vitin 2019 (1,329,188€) kishin shënuar rënie të lehtë prej 13%, në vitin 2020 (2,379,638€) me rritje prej 44% dhe respektivisht në vitin 2021(2,957,689€) rritje prej 20%; për NJB Kopaonik-Leposaviç nga viti 2018 (2,621,183€) në vitin 2019 (3,940,171€) rritja ishte 33%, dhe se për vitin 2020 (5,121,130€) rritja ishte 23% dhe respektivisht për vitin 2021(5,091,257€) zvogëlim i lehtë.

Si për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, poashtu edhe për NJB Kopaonik-Leposaviç, trend progresiv rritës ndër vite kanë shënuar të arkëtueshmet tregtare, kërkesat për TVSH dhe kërkesat tjera. Regjistri i llogarive për kërkesat ndaj TVSH-së ka shënuar trend progresiv rritës ndër vite. Pretendimet për shumën 3,733,240€ e prezantuar në fund të vitit 2021, rrjedhin nga rasti i NJB Kopaonik-Leposaviç ka ndaj ATK për mos njohje të shpenzimeve të zbritshme nga periudha 2014 dhe 2015. Kërkesat tjera përfshijnë të arkëtueshme 706,084€ që NJB Kopaonik-Leposaviç pret t'i realizoj nga Trepça Sh.A. sipas procesverbalit⁷² ku specifikohet për këto mjete të rimbursuara nga TVSH-ja për periudhën

70. Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, pika 1 dhe 2

71. Në zërin financiar të të arkëtueshmeve janë përfshirë edhe llogari të arkëtueshme të bartura nga koha kur Trepça ishte NSH nën administrimin e AKP-së

72. Procesverbalit me numër reference 3936 i dt. 25/11/2019 në mes të NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe NJB Kopaonik-Leposaviç

2013-2015. Rritje të theksuar ndër vite kishte edhe për kërkesat e arkëtueshme tregtare të NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë – Artanë si dhe njësive tjera biznesore llogari këto që përfshijnë mjete të cilat pret t'i realizoj sipas marrëveshjeve kontraktuale me blerësit dhe qiramarrësit, dhe të cilat nuk janë realizuar si shkak i vonesave në barazime të faturave finale për shitje të koncentrateve. Poashtu në këtë zë janë përfshirë edhe saldo të bartura nga vitet paraprake si borxhe të vjetra dhe për të cilat nuk është përlllogaritur vjetërsia në baza konsistente, dhe se sipas konfirmimit të zyrës ligjore disa edhe mund të jenë parashkruar⁷³ dhe të njëjtat nuk mund të procedohen tutje në procedura gjyqësore dhe përmbartimore për realizim të borxhit për shkak se nuk janë siguruar dëshmitë burimore nga zyra e financave dhe shitjes.

Trendi në rritje i kërkesave të arkëtueshme rrezikon likuiditetin e kompanisë dhe paraqet rrezik për kryerjen e pagesave ndaj obligimeve kontraktuale dhe obligimeve tjera që rrjedhin nga aktivitetet biznesore të kompanisë.

3.3.4 Numër i lart i rasteve në konteste gjyqësore dhe përmbartimore

Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar që Trepça Sh.A dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat dhe Rregullat⁷⁴, vendosjen e kontrollit të brendshëm, dhe delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike.

Trepça Sh.A. ka numër të madh të rasteve me të cilat ballafaqohet si në cilësinë e palës debitoare, poashtu edhe kreditore, në konteste gjyqësore dhe përmbartimore. Në vazhdim paraqesim rastet dhe pretendimet, përfshirë edhe shumën e mjeteve, për periudhën 2019-2021:

Tabela 13. Nr. rasteve/procedurave në konteste gjyqësore dhe përmbartimore

	Nr. rasteve/procedurave në konteste gjyqësore dhe përmbartimore	Baza	Vlera (€)
Trepça si debitoare	50	Borxhe ndaj OE	2,163,662
	Trepça Sh.A. ka 666 raste në procedurë gjyqësore për pagat jubilare ku punëtorët kanë ngritur padi, dhe për këto raste sipas zyrës ligjore shuma nuk është përcaktuar		
Trepça si kreditore	8	Borxhe, Dëmshpërblim, Padi për lirim e objektit	534,185 ⁷⁵

73. Konfirmimi sipas zyrës ligjore të Trepça Sh.A

74. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221 dhe Ligjin Nr.04/L-116, neni 2: Përkufizimi "Rregullat e KMF" riformulohet si në vijim: "Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit (MFK)" është një sistem gjithëpërfshirës i politikave, procedurave, aktiviteteve dhe përgjegjësi për të menaxhuar dhe kontrolluar shfrytëzimin e fondeve publike, ku përfshihen të hyrat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet, bazuar në menaxhimin e rrezikut, me qëllim të ofrimit të sigurisë, që objektivat e institucionit do të arrihen në mënyrë ligjore, ekonomike, efikase dhe efektive.

75. Në raportin vjetor të Trepça Sh.A. për vitin 2021 janë shpalosur edhe rastet e inciuara gjatë vitit 2022 dhe që në total janë prezantuar afër 1,000,000€.

Procedurat gjyqësore të kërcënuara me përmbarues privat si dhe pagesa të obligimeve të realizuara nga Trepça Sh.A. përmes procedurave përmbarimore për periudhën 2020-2021 i paraqesim në vijim:

760,000€ janë në Gjykatën e Apelit, 240,000€ janë në Gjykatën Themelore, Marrëveshja me KEK-un mbi 1,000,000€. Pagesa të obligimeve të realizuara për pesë raste përmes procedurave përmbarimore në cilësinë e debitorit ishin 100,513€, ndërsa pagesa të pranuar në cilësinë e palës kreditore 25,884€.

NJB Kopaonik-Leposaviç ka vetinciuar në vitin 2016 padi ndaj Administratës Tatimore të Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për mos njohje të shpenzimeve të zbritshme nga periodha 2014 dhe 2015. Pretendimet janë shpalosur në pasqyrat financiare të vitit 2021, të arkëtueshme në shumë 3,733,240€.

Sipas konfirmimeve nga zyra ligjore e Trepça Sh.A., numri i madh i rasteve ku Trepça Sh.A. është debitor është si pasojë e pamundësisë së pagesës së obligimeve kontraktuale ndaj operatorëve të ndryshëm, të cilët kanë realizuar kontratat mirëpo Trepça për shkak të mungesës së mjeteve financiare nuk ka arritur të përmbush detyrimin e saj dhe të njëjtit kërkojnë realizimin e borxhit përmes institucioneve juridike. Ndërsa, rastet në cilësinë e Trepça Sh.A. si kreditor rezultojnë nga borxhet me blerësit, dëmshpërblimet dhe paditë për lirimin e objekteve të Trepça Sh.A.

Ballafaqimi i Trepça Sh.A. me këto raste, rrezikon në vazhdimësi likuiditetin e kompanisë, duke krijuar edhe shpenzime shtesë gjyqësore dhe përmbarimore, si dhe bllokimin e llogarive bankare dhe pamundësi për pagesë me kohë.

3.4 Investimet kapitale në teknologjinë/infrastrukturën prodhuese

Planifikimi është një element kyç i një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm dhe përfshinë planet operative dhe financiare, të cilat duhet të udhëhiqen nga iniciativat e politikave të ndërmarrjes. Projektet kapitale të propozuara nga NP-të duhet të jenë në përputhje me objektivat e synuara dhe të parashihen në planin e biznesit⁷⁶. Investimet kapitale sigurojnë vazhdimësi të procesit të prodhimit. Vlerësimi i nevojave për investime kapitale bëhet për përmbushjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes. Përmes planeve të mirëmbajtjes industriale synohet të rritet niveli i përdorimit të kapaciteteve prodhuese, të ruhen ose rivoendosen pajisjet për të përmbushur funksionin e tyre prodhues, për të arritur efikasitetin maksimal të makinës me konsumim minimal.


Trepça Sh.A. ballafaqohet me probleme dhe sfida të shumta. Sfidë kryesore e kësaj ndërmarrje është teknologjia e stërvjetëruar në miniera dhe flotacione. Shumica e makinerive dhe pajisjeve në NJB prodhuese janë të viteve të '60-70-ta, mirëpo ka makineri edhe të viteve më të hershme. Si shkak i trendit të operimit me humbje dhe problemeve

76. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 30

financiare të cilat po e përcjellin vit pas viti, investimet e vetme kapitale të cilat janë realizuar viteve të fundit në NJB Stan Tërg dhe NJB Kopaonik-Leposaviç janë investimet me subvencionet e ndara nga Buxheti i Kosovës, ndërsa - NJB Kopaonik-Leposaviç ka pas investime kapitale edhe nga buxheti vetanak, investime këto të cilat synojnë të sigurojnë vazhdimësinë e procesit të prodhimit.

Trepça Sh.A. vlerësimin e nevojave për investime kapitale e paraqet çdo vit përmes planeve të biznesit. Qeveria për vitet 2018-2021 ka ndarë subvencione për investimet kapitale për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë në vlerë prej 4,479,148 €, ndërsa për NJB Kopaonik-Leposaviç në vlerë prej 1,400,000 €⁷⁷. Ndërsa në grafikun e mëposhtëm kemi prezantuar subvencionet nga Buxheti i Kosovës për njësitë biznesore të Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021:

Grafiku 15. Subvencionet për investime kapitale nga Buxheti i Kosovës për vitet 2019-2021⁷⁸



Qeveria e Kosovës për vitet 2019-2021 ka ndarë subvencione për investimet kapitale për Trepça Sh.A. në vlerë prej 4,144,148 €, ku nga totali i kësaj shume rreth 76% janë destinuar për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, ndërsa rreth 24% janë ndarë për NJB Kopaonik-Leposaviç. Ndërsa, NJB Kopaonik-Leposaviç për periudhën 2019-2021 ka realizuar investime kapitale me buxhet vetanak në vlerë prej 134,002 €.

Përveç projekteve kapitale të cilat janë financuar respektivisht subvencionuar nga Buxheti i Kosovës në periudhën 2019-2021, Trepça Sh.A. me plan të biznesit për vitet 2019-2021, ka bërë identifikimin e nevojave edhe për investime të tjera kapitale, të cilat janë në pritje të financimit me buxhet të Kosovës, apo me buxhet vetanak. Vlerën e investimeve kapitale të cilat janë në pritje të financimit e kemi paraqitur në tabelën në vijim:

77. Viti 2018, nuk ka qenë fushëveprim i auditimit, mirëpo është marrë vetëm për qëllime krahasimore

78. Marrëveshjet e monitorimit dhe kontrollit në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Trepça Sh.A. për vitet 2019-2021

Tabela 14. Investimet Kapitale në pritje të financimit

Viti	NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe tjera '000 (€)	Nr. projekteve Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë Artanë dhe tjera ⁷⁹	NJB Kopaonik-Leposaviç '000 (€)
2019	1,638,095	33	856,644
2020	9,757,372	38	777,588
2021	8,810,854	24	800,901
Total	20,206,321		2,435,133

Përmes këtyre projekteve kapitale janë paraparë investime të ndryshme si: hapja e korridoreve në horizontet e minierave, rregullimi hekurudhave, riaftësimi horizonteve, investime në sektorin e energjisë në miniera dhe vendosjen e largpërçuesve, furnizime me makineri dhe pajisje, vendosja e linjave të reja për nxjerrjen e ujit nga miniera, projektimi dhe vendosja e ashensorit për bartjen e punëtorëve në minierë, investime në stacionin e ventilimit, investime në thërrmuesin primar-sekondar-terciar në flotacione, punime përgatitore për shfrytëzimin e trupave xeheror, rivitalizimi i korridoreve nëpër horizonte, dhe projektimi për trajtimin e ujërave acidike.

Për shkak të gjendjes së rënduar financiare që po përcjellët në vazhdimësi dhe pamundësisë së financimit vetanak, këto projekte me potencial zhvillimor ishin bartur vit pas viti. Poashtu, nuk kishte ndonjë financim as nga aksionari. Ngecjet në realizim të projekteve kapitale kanë ndikim direkt në produktivitet dhe vazhdimësi të procesit të prodhimit me teknologji bashkëkohore të industrisë.

79. Sipas Planeve të Biznesit 2019-2021

3.4.1 Projektet kapitale të realizuara me financim nga aksionari

Investimet për projektet kapitale të planifikuara për vitin 2019 për NJB Stan Tërg ishin 1,335,000 € projekte këto të cilat janë financuar nga Buxheti i Kosovës pa plan të aprovuar biznesi. Ndërsa, NJB Kishnicë-Artanë - për vitin 2019 nuk kishte përfituar mjete financiare nga Buxheti i Kosovës, në mungesë të përfshirjes së projekt propozimit me vlerësimin financiar për investime kapitale⁸⁰. Zyrtarët⁸¹ përgjegjës të kompanisë nuk kanë arritur të na ofrojnë dëshmi se si i kanë proceduar kërkesat për investime kapitale në Ministri për periudhën 2019-2021, para se të nënshkruhen Marrëveshjet e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të Ministrisë dhe Trepça Sh.A⁸².

Në tabelën në vijim kemi paraqitur planifikimin dhe realizimin e projekteve kapitale sipas Planit të Biznesit të Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, për periudhën 2019-2021:

Tabela 15. Subvencionet nga buxheti i Kosovës dhe realizimi i projekteve kapitale për periudhën 2019-2021, NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë

Projektet kapitale	Hapja e vendpunishteve të reja në horizontet X-XI, në Minierën me Flotacion Stan tërg			Riaftësimi i vend punishteve në horizontin IX dhe VIII, në Minierën me Flotacion Stan Tërg			Renovimi i banjove për pastrimin e punëtorëve në Minierën me Flotacion Stan Tërg			Hapja dhe përgatitja e trupit xehëror ndërmjet horz. IV-V-VI, Miniera Kishnicë-Artanë		
	Planifikimi (€)	Realizimi (€)	%	Planifikimi (€)	Realizimi (€)	%	Planifikimi (€)	Realizimi (€)	%	Planifikimi (€)	Realizimi (€)	%
2019	645,000	572,740	88.80	722,000	697,092	96.55	-	-	-	-	-	-
2020	738,400	709,000	96.02	-	-	-	136,148	93,992	69.04	244,950	200,000	81.65
2021	709,000	599,778	84.59	757,000	-	-	-	-	-	200,000	203,406	101.70
Total	2,092,400	1,881,518	89.92	1,479,000	697,092	47.13	136,148	93,992	69.04	444,950	403,406	90.66

Në vazhdim shpalosim pjesëmarrjen e furnizimeve sipas projekteve kapitale:

80. NJB Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë, na ka ofruar si dëshmi vetëm Projektin e Shfrytëzimit të Trupit.minerar. IV-V për Minierën e Artanës, korrik 2011

81. Konfirmimi përmes e-mailës se nuk posedojnë dëshmitë në arkivë


82. Marrëveshjet e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të Ministrisë dhe NP Trepça, janë nënshkruar për 3 vite, me dt.14.03.2019, 11.03.2020, 16.02.2021

Tabela 16. Furnizimet sipas projekteve kapitale ('000 €) , 2019-2021

Projektet kapitale	Hapja e vendpunishteve të reja në horizontet X-XI, në Minierën me Flotacion Stan tërëg			Riaftësimi i vend punishteve në horizontin IX dhe VIII, në Minierën me Flotacion Stan Tërg			Renovimi i banjove për pastrimin e punëtorëve në Minierën me Flotacion Stan Tërg			Hapja dhe përgatitja e trupit xehëror ndërmjet horz. IV-V-VI, Miniera Kishnicë-Artanë		
Furnizimet sipas linjave buxhetore	Furnizime për mirëmbajtje elektrike të pajisjeve prodhuese , mirëmbajtje mekanike dhe material ndërtimor për mirëmbajtje	704,847	37.53%	Pjesë rezervë	302,619	43.41%	Renovimi i banjove për pastrimin e punëtorëve në minierën me flotacion në Stantërg	59,217	63%	Pjesë rezervë	173,133	42.92%
	Pjesë rezervë për impiante, autogoma për makinë produktive në përdorim, riparimet e veglave dhe paisjeve	846,195	45.05%	Material për miëmbajtje mekanike, riparimet e veglave dhe paisjeve	10,358	1.49%	Furnizim me gypa për ajër të komprimuar dhe për ujë	34,775	37%	Materiale mekanike për mirëmbajtje të paisjeve prodhuese, materiale ndërtimore	78,358	19.42%
	Eksplziv, detonator, material i imët hargjues për prodhim	327,293	17.42%	Material i imët hargjues për prodhim, vegla të imta në përdorim	83,094	11.92%				Sfera Celi-ku, impiante dhe makineri mekanike të prodhimit dhe përpunimit, vegla të imta në përdorim	160,859	39.88%
				Autogoma për makina produktive në përdorim, vegla të imta në përdorim	301,030	43.18%						
Total		1,881,518	100%		697,092	100%	-	93,992	100%	-	403,406	100%

Furnizimet për projektet kapitale janë realizuar duke u bazuar në legjislacionin e prokurimit publik sipas kërkesave të marrëveshjeve të monitorimit dhe kontrollit mes Trepça Sh.A. dhe Ministrisë së Ekonomisë (NJPMNP) për subvencionimin e investimeve 2019-2021. Nga tabela më lart mund të shohim se furnizimet për projektet kapitale kryesisht ishin materiale shpenzuese për procesin e prodhimit, pjesë rezervë për pajisje dhe makineri, vegla të imta në përdorim dhe të tjera. Grafiku në vijim paraqet furnizimet me pajisje kapitale nga projektet e Trepça Sh.A. për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, për 2019-2021:

Grafiku 16. Furnizimet me pajisje kapitale sipas projekteve të Trepça Sh.A. ('000 €):



Realizimi projekteve për vitin 2021 ishte më i ulët për shkak se projekti “Riaftësimi i vend punishteve në horizontin IX dhe VIII, në Minierën me Flotacion Stan Tërg” i planifikuar në shumë 757,000 € nuk ishte financuar nga aksionari. Pra, sipas Marrëveshjes në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Trepça Sh.A.⁸³ janë ndarë 800,000 € për investime kapitale për të dy NJB, pa e specifikuar shumën dhe projektin për cilën Njësi. Buxheti i ndarë sipas marrëveshjes ishte shpenzuar 100% gjatë vitit 2021, mirëpo tek Projekti “ Hapja dhe përgatitja e trupit xeheror ndërmjet horizontit IV-V-VI, Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë” gjatë vitit 2021 ka pas tejkalim të shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale për 3,405 € në krahasim me planin e biznesit.

Projekti “ Hapja e vend punishteve të reja në horizontet X - XI , në Minierën me Flotacion Stan Tërg” ka pas realizim 84.59% gjatë vitit 2021 në krahasim me vlerën e parashikuar me plan të biznesit fillestar si shkak i kufizimit buxhetor të alokuar nga qeveria, ku mjetet buxhetore ishin destinuar nga Trepça Sh.A. për dy projektet e njëjësive biznesore Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë ndërsa sipas rishikimit të planit të biznesit 2021 shuma e planifikuar e këtij projekti ishte 600,000€. Pra, ky realizim ishte në përputhje me shumën e ndarë të buxhetit nga Qeveria. Për Projektet kapitale të cilat janë financuar me mjete nga buxheti i Kosovës, nuk kemi arritur të sigurojmë dëshmi për vlerën totale të projekt-propozimeve investive si dhe kohëzgjatjen e realizimit të tyre. Sipas të dhënave

83. Marrëveshja në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Trepça SH.A., dt.16.02.2021

të paraqitura në tabelën më lartë, për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë ka pasur shkurtime buxhetore nga Qeveria për investime kapitale gjatë viteve 2020 dhe 2021.

NJB Kopaonik-Leposaviç për çdo vit ka hartuar Planin e biznesit, i cili nuk është shqyrtuar dhe aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës, mirëpo është aprovuar vetëm nga ana e zyrtarëve menaxhues të NJB Kopaonik-Leposaviç. Për periudhën 2019-2021, nga Buxheti i Kosovës janë ndarë 1,000,000€ për financimin e investimeve kapitale të kësaj njësie biznesore⁸⁴, si dhe janë realizuar 991,865€, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 17. Subvencionet nga buxheti i Kosovës dhe realizimi i projekteve kapitale për periudhën 2019-2021, NJB Kopaonik-Leposaviç

Viti	Mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës '000(€)	Investimet kapitale ⁸⁵ të cilat janë realizuar me mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës'000(€)	Realizimi %
2019	400,000	394,356	98.59
2020	400,000	398,840	99.71
2021	200,000	198,669	99.33
Total	1,000,000	991,865	99.19

NJB Kopaonik-Leposaviç me mjetet e ndara nga buxheti i Kosovës për investime kapitale, ka blerë makineri për miniera të cilat janë të klasifikuara si investime kapitale.

Nga totali i mjeteve të shpenzuara nga buxheti i Kosovës për projektet kapitale për vitin 2019, 59% e tyre janë investuar në Minierën e Crnait, kurse 41% në Minierën e Belobrdos. Në vitin 2020, të gjitha mjetet janë shpenzuar për Minierën e Crnait. Ndërsa në vitin 2021, 79% janë shpenzuar për Minierën e Crnait, kurse 21% për Minierën e Belobrdos. Përveç mjeteve financiare nga Buxheti i Kosovës, NJB Kopaonik-Leposaviç gjatë periudhës 2020-2021 ka pas investime kapitale edhe nga buxheti vetanak në vlerë prej 134,002€. Investimet kapitale me buxhet vetanak në vitin 2020 janë realizuar në Minierën e Belobrdos, përderisa në vitin 2021, investimet janë realizuar në të dy Minierat. Realizimi i investimeve kapitale për periudhën 2019-2021 sipas subvencioneve të ndara nga Buxheti i Kosovës, ishte 41% për Minierën e Bello Bërdo dhe 59% për Minierën e Cërncit.

Shkakun se pse ka ndodh mos aprovimi i planit të biznesit për vitin 2019 për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë nga ana e Bordit Mbikëqyrës, zyrtarët përgjegjës të Trepçës nuk kanë arritur ta dëshmojnë. Ndërsa mos aprovimi i planeve të biznesit të NJB Kopaonik-Leposaviç nga Bordi Mbikëqyrës për periudhën 2019-2021, ka ndodhur si shkak se Bordi respektiv nuk ka arritur t'i ketë në dispozicion planet për shqyrtim dhe aprovim.

84. Marrëveshjet e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të MZHE dhe Trepça Sh.A. për periudhën 2019-2021


85. Tabela analitike e investimeve kapitale

Financimi i projekteve kapitale me mjete nga Buxheti i Kosovës në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies si dhe planeve të pa aprovuara të biznesit nga Bordi Mbikëqyrës, mund të ndikoj në zhvillimin e aktiviteteve operative dhe financiare pa planifikim të mirëfilltë. Po ashtu, Bordi Mbikëqyrës si organi më i lartë mbikëqyrës i Trepça Sh.A. mund të mos jetë i informuar rreth aktiviteteve operative dhe financiare që zhvillohen në NJB Kopaonik-Leposaviç.

3.5 Burimet njerëzore në procesin e prodhimit

Trepça Sh.A ka një numër të konsiderueshëm të të punësuarve. Numrin e përgjithshëm të të punësuarve për vitet 2019-2021 e kemi paraqitur përmes grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 17. Numri i të punësuarve në Trepça Sh.A., 2019-2021



Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mbi 30% janë të punësuar në njësitë biznesore Stan Tërg , Kishnicë -Artanë dhe të tjera ndërsa mbi 60% në NJB Kopaonik-Leposaviç. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në NJB Kopaonik-Leposaviç ,rreth 700-800 të punësuar nuk mund të angazhohen vazhdimisht në punë por ata punojnë me rotacion dhe pagohen përmes stipendioneve, dhe përmes kësaj forme të angazhimit atyre ju mundësohet të punojnë disa muaj gjatë vitit. Numri i të punësuarve në Miniera dhe Flotacione, në raport me numrin e përgjithshëm të të punësuarve Trepça Sh.A. është paraqitur në tabelat dhe grafikonet e mëposhtme për periudhën 2019-2021:

Tabela 18. Numri i të punësuarve në njësitë biznesore të Trepça Sh.A⁸⁶. 2019-2021

Njësitë Biznesore	2019	2020	2021
Miniera me Flotacion Stan Tërg	552	727	747
Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë	243	276	259
Metalurgjia e Zinkut	40	34	30
Industria Kimike	26	26	21
Industria e Akumulatorëve	22	19	5
Fabrika e Pajimeve dhe Pajisjeve	38	40	39
Stabilimentet Energjetike	10	10	11
Kompleksi Administrativ i Kishnicës në Prishtinë	2	3	3
Menaxhmenti	44	46	46
Mjekësia e punës	4	5	5
Fabrika e Municionit të Gjuetisë ⁽⁸⁷⁾	3	3	3
Fabrika për përpunimin e mbetjeve të akumulatorëve	29	28	27
Industria e Akumulatorëve	123	119	114
Energjetika	61	57	56
Fabrika e Baterive Pejë	8	7	7
FZO	14	14	14
Instituti i Kimisë	28	28	28
Igal	17	16	16
Instituti i Kimisë	32	30	31
Laboratori	44	43	42
Menaxhment	11	12	11
Sigurimi	88	87	88
Sigurimi Lepasaviç	65	64	64
Mirëmbajtja Lepasaviç	37	35	35
Fabrika e Gurit Blu	89	85	84
Prelez	6	6	6

86. Listat e stafit në Trepça Sh.A.

87. Kjo njësi nuk është paraparë me Ligjin për Trepça Sh.A. si dhe Statutin e Kompanisë.

Procesim	48	44	44
Rafinerija	134	121	116
Standard	88	82	82
Standard Leposaviç	32	32	33
Stari Tërg	73	62	59
TOP	39	36	37
Topianica	176	161	155
Transport	61	58	59
Total	2,998	3,127	3,135

Në vitin 2019, në NJB Stan Tërg 52% e të punësuarve kanë qenë të angazhuar në minierë në krahasim me numrin e përgjithshëm të të punësuarve, kurse 11% në flotacion. Në vitin 2020, përqindja e të angazhuarve në minierë ka shënuar një rritje, ku 58% kanë qenë të angazhuar në minierë, kurse përqindja e të angazhuarve në flotacion ka mbetur pothuajse e njëjtë 11%. Trendi ka mbetur i njëjtë edhe në vitin 2021, ku 58% e të punësuarve kanë qenë të angazhuar në minierë, kurse 12% në flotacion. Në NJB Kishnicë-Artanë, në vitin 2019 numri i të punësuarve në minierë ka qenë 33%, kurse në flotacion 17%. Në vitin 2020, numri i të punësuarve në minierë ka qenë 29%, kurse në flotacion 15%. Ndërsa në vitin 2021, përqindja e të punësuarve në prodhim ka shënuar një rritje të lehtë, ku 40% e të punësuarve kanë qenë të angazhuar në minierë, kurse 20% në flotacion.

Në vitin 2019, në NJB Kopaonik -Leposaviç, 28% e të punësuarve kanë qenë të angazhuar në procesin e prodhimit në Miniera dhe Flotacion, në krahasim me numrin e përgjithshëm të të punësuarve. Në vitin 2020, përqindja e të angazhuarve në prodhim ka qenë 29%, përderisa në vitin 2021 përqindja e të angazhuarve në prodhim ka shënuar një rritje të lehtë dhe ka arritur në 31%. Përveç të punësuarve të rregullt, Trepça Sh.A. ka të punësuar edhe punëtorë me kontrata për punë dhe detyra specifike. Gjatë periudhës 2019-2021, në njësitë biznesore Stan Tërg , Kishnicë-Artanë dhe të tjera 237 punëtorë janë pensionuar apo kanë vdekur, përderisa në njësinë biznesore Kopaonik-Leposaviç 128 punëtorë janë pensionuar.

Sfidë me të cilën përballët Trepça Sh.A. është moshë e shtyer e të punësuarve si dhe faktor me ndikim në produktivitet në procesin e prodhimit. Në vazhdim paraqesim të pasqyruar moshën e të punësuarve në njësitë biznesore prodhuese:

Tabela 19. Mosha e të punësuarve në NJB prodhuese për vitin 2021

NJB, Viti 2021	Nr. Total i të punësuarve	Nr. Total i të punësuarve mbi moshën 55 vjeçare	% e të punësuarve mbi moshën 55 vjeçare	Nr. i punësuarve në prodhim mbi moshën 55 vjeçare	% e të punësuarve në prodhim mbi moshën 55
Miniera me Flotacion Stan Tërg	747	242	32	140	27
Miniera me Flotacion Kishnicë- Artanë	259	108	42	43	28
Minierën Belobrd	248	62	25	39	63
Minierën Crnac	268	67	25	35	52
Flotacioni Leposaviç	99	30	30	16	53

3.5.1 Mungesë e analizës dhe identifikimit të nevojave për angazhimin e punëtorëve në prodhim

Planifikimi i burimeve njerëzore është një proces i analizimit të fuqisë punëtore aktuale, përcaktimit të nevojave të ardhshme të fuqisë punëtore, identifikimit të hendekut midis fuqisë punëtore që janë në dispozicion dhe nevojave të ardhshme dhe zbatimit të zgjidhjeve në mënyrë që një organizatë të arrijë misionin, qëllimet dhe planin strategjik të saj.⁸⁸

Planet e Biznesit për periudhën 2019-2021 nuk përmbajnë analizë se sa duhet të jetë numri i punëtorëve të angazhuar direkt në procesin e prodhimit për NJB Miniera me Flotacion Stan Tërg dhe Miniera me Flotacion Kishnicë -Artanë. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në këto Miniera dhe në Flotacione⁸⁹, të angazhuar në procesin e prodhimit kanë qenë numër i ultë i punëtorëve. Numri i të punësuarve në njësitë prodhuese është paraqitur si në vijim:

88. https://www.cipd.co.uk/Images/workforce-planning-guide_tcm18-42735.pdf

89. Lista e të punësuarve në NJB Miniera me Flotacion Stan Tërg dhe KHA

Tabela 20. Numri i të punësuarve në prodhim në NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë

Njësia Biznesore			Nr. i punëtorëve në prodhim		% e Punëtorëve në prodhim në raport me nr.total të punëtorëve	
	Viti	Total nr. i punëtorëve	Punëtorët në Minierë	Punëtorët në Flotacion	% e Punëtorëve në Minierë	% e Punëtorëve në Flotacion
Miniera me Flotacion Stan Tërg	2019	552	288	61	52	11
Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë		243	80	40	33	17
Miniera me Flotacion Stan Tërg	2020	727	419	83	58	11
Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë		276	79	41	29	15
Miniera me Flotacion Stan Tërg	2021	747	432	92	58	12
Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë		259	102	51	40	20

Përqindja në nivel jo të kënaqshëm i të angazhuarve direkt në procesin e prodhimit ka ndodhur si shkak i mos identifikimit të mirë të nevojave për angazhimin e punëtorëve në prodhim. Orientimi i fuqisë punëtore në nivel jo të kënaqshëm në procesin e prodhimit ka ndikim direkt në produktivitet të ulët të prodhimit. Përderisa, NJB Kopaonik-Leposaviç angazhimin e të punësuarve në procesin e prodhimit e ka zgjidhur përmes kontraktimit të jashtëm të kompanisë e cila sipas kontratës obligohet të kryej 30% të punës së planifikuar minerare në muaj.

3.5.2 Tejkallim i stafit të punësuar në krahasim me shpalljen publike me konkurs

Planifikimi i burimeve njerëzore është një proces i analizimit të fuqisë punëtore aktuale, përcaktimit të nevojave të ardhshme të fuqisë punëtore, identifikimit të hendeikut midis fuqisë punëtore që janë në dispozicion dhe nevojave të ardhshme dhe zbatimit të zgjidhjeve në mënyrë që një organizatë të arrijë misionin, qëllimet dhe planin strategjik të saj.⁹⁰

Plani i Biznesit për vitin 2019 të Trepça Sh.A. nuk përmban informata se sa është numri i saktë i nevojave për rekrutimin e punëtorëve të rinj përfshirë dhe kushtet tjera për plotësimin e vendeve të punës. Si rrjedhojë e kësaj, as shpallja e konkursit të dt.24/09/2019, nuk ka qenë e përfshirë me plan. Numri i pozitave të lira të shpallura me këtë konkurs si dhe numri i të punësuarve në NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë përmes të njëjtit konkurs, është paraqitur në vijim:⁹¹

Tabela 21. Numri i pozitave të shpallura me konkurs dhe numri i të rekrutuarve

Pozitat e shpallura	Numri i pozitave të shpallura në NJB Stan Tërg	Numri i të pranuarve në punë në NJB Stan Tërg	Numri i pozitave të shpallura në NJB Kishnicë -Artanë	Numri i të pranuarve në punë në NJB Kishnicë-Artanë
Punëtorë në Prodhim	120	144	30	32
Punëtorë në Flotacion	15	21	12	17

Përderisa, në konkursin e shpallur në vitin 2020 në Trepça Sh.A. nuk ka pas tejkallim të të punësuarve në krahasim me vendet e lira të shpallura me konkurs. Njëkohësisht , as NJB Kopaonik-Leposaviç në konkurset e shpallura gjatë periudhës 2019-2021, nuk ka pas tejkallim të të punësuarve në krahasim me vendet e lira të shpallura me konkurs.

Mos identifikimi në plan të biznesit për rekrutimin e punëtorëve të rinj ka pasur ndikim në planifikim jo të saktë të nevojave për angazhimin e fuqisë punëtore. Po ashtu, në tejkallimin e numrit të punëtorëve të pranuar në punë ka ndikuar edhe vlerësimi i Komisionit përzgjedhës, i cili ka bërë vlerësimin e 37 kandidatëve me pikë të njëjta.

Pranimi i numrit më të madh të të punësuarve në krahasim me vendet e lira të shpallura me konkurs, ka implikim edhe me shpenzime shtesë të pa planifikuara.

90. https://www.cipd.co.uk/Images/workforce-planning-guide_tcm18-42735.pdf

91. Konkursi i shpallur në vitin 2019, lista e stafit të pranuar në punë sipas këtij konkursi

3.5.3 Lëvizjet dhe gradimet e stafit nëpër pozita dhe njësi biznesore

Planifikimi i burimeve njerëzore është një proces i analizimit të fuqisë punëtore aktuale, përcaktimit të nevojave të ardhshme të fuqisë punëtore, identifikimit të hendeikut midis fuqisë punëtore që janë në dispozicion dhe nevojave të ardhshme dhe zbatimit të zgjidhjeve në mënyrë që një organizatë të arrijë misionin, qëllimet dhe planin strategjik të saj.⁹²

Trepça Sh.A. nuk ka rregullore apo politika të brendshme përmes të cilave do të përcaktoheshin kushtet dhe kriteret për gradimet e stafit nga njëra pozitë në tjetrën, brenda njësive biznesore. Përderisa, lëvizja e stafit nga njëra njësi biznesore në tjetrën që nga gjysma e dytë e vitit 2020, është e rregulluar përmes Rregullores për Marrëdhënie Pune.⁹³ Numri i lëvizjeve të stafit për periudhën 2019-2021 nga njësitë biznesore Stan Tërg dhe Kishnicë-Artanë ishte 91, ndërsa nga NJB Kopaonik-Leposaviç⁹⁴ ishin 49 lëvizje. Përshkrim i detajuar i lëvizjeve është paraqitur në vazhdim:

NJB Miniera me Flotacion Stan Tërg 2019-2021

Lëvizjet e stafit në mes të NJB- Në Parkun Industrial të Mitrovicës(PIM)⁹⁵ kanë ndodhur pesë transferime, kurse vetëm gjatë vitit 2020, dy zyrtarë janë angazhuar përkohësisht me punë shtesë në PIM. Nga këto shtatë transferime, katër prej tyre janë përzgjedhur për mostrim dhe kemi vërejtur se lëvizja e stafit është bërë me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv⁹⁶.

Lëvizjet brenda NJB- Brenda Njesisë biznesore kanë ndodhur 36 lëvizje të punëtorëve nga njëra pozitë në tjetrën. Nga këto lëvizje, në katër mostrat e përzgjedhura identifikua se lëvizjet e stafit kanë ndodhur me vendim të udhëheqësit të NJB, nga një pozitë më e ultë në një pozitë më të lartë.

NJB Miniera me Flotacion Kishnicë 2019-2021

Lëvizjet e stafit në mes të NJB- Kanë ndodhur tetë transferime në NJB Miniera me Flotacion Stan Tërg, dhe një lëvizje në PIM⁹⁷. Nga pesë mostrat e përzgjedhura për këto transferime, kemi vërejtur se në vitin 2021 ka ndodhur lëvizja e dy inxhinierëve të cilët janë pranuar në punë me konkursin e fundit të shpallur në vitin 2020. Lëvizja e inxhinierëve është bërë me kërkesë të tyre dhe me dhënien e pëlqimit të udhëheqësit të NJB pasuar pastaj me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv⁹⁸. Kurse, në tri raste të tjera lëvizja e stafit ishte bërë vetëm me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv.

92. https://www.cipd.co.uk/Images/workforce-planning-guide_tcm18-42735.pdf

93. Rregullore për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A, neni 33 pika 3, hyrja në fuqi me 30.07.2020

94. Lëvizjet e stafit për periudhën 2019-2021

95. Lista e transfereve të stafit, ST

96. Vendimet e KE, për transferet nga ST.

97. Lista e lëvizjeve të stafit nga KHA në Mitrovicë, 2019-2021, KHA

98. Vendimet e KE për transfer

Lëvizjet brenda NJB- Nga brenda NJB për periudhën e njëjtë, kanë ndodhur 40 lëvizje të punëtorëve nga njëra pozitë në tjetrën, ku 28 kanë ndodhur vetëm brenda Minierës së Artanës. Nga katër mostrat e përzgjedhura, identifikua se lëvizjet e tyre janë bërë me aprovimin e udhëheqësit të NJB respektive.

Lëvizjet e stafit nëpër vite nga NJB Kopaonik-Leposaviç

Gjatë vitit 2019, dy lëvizje kanë ndodhur brenda Flotacionit në Leposaviç, një lëvizje në Minierën e Crnacit, si dhe një lëvizje prej Flotacionit në Minierën e Crnacit. Gjatë 2020, 11 lëvizje kanë ndodhur brenda Minerës së Crnacit, gjashtë në Belobrd, një lëvizje në Leposaviç, tri lëvizje në Metalurgji të Pb, një në Laborator, një në Energjetikë dhe dy lëvizje në Administratë. Gjatë vitit 2021, katër lëvizje në Flotacion, gjashtë në Minierën Belobrd, shtatë në Crnac, dy në Administratë, dhe një lëvizje në Shkritore.

Nga këto lëvizje të stafit, për NJB Kopaonik-Leposaviç⁹⁹ si mostër kemi marrë nga tri lëvizje për secilin vit, ku në shtatë raste kemi identifikuar se lëvizjet kanë ndodhur nga një pozitë më e ultë në një pozitë më të lartë, ndërsa në dy raste lëvizjet kanë ndodhur për punë shtesë në pozitën e re. Të gjitha këto lëvizje të stafit kanë ndodhur pa qenë të rregulluara me politika të brendshme, përmes rregullores për organizimin e brendshëm.

Lëvizjet e stafit nga NJB Stan Tërg në menaxhment në PIM janë bërë me arsyetimin e koordinimit më të mirë të punëve për zhvillimin e Trepça Sh.A. kurse lëvizjet nga NJB Kishnicë-Artanë në NJB Stan Tërg janë bërë për shkak të rritjes së vëllimit të punëve në NJB Stan Tërg dhe nevojës së rritjes së kapaciteteve njerëzore në këtë njësi. Lëvizjet e stafit brenda NJB përkatëse janë bërë me arsyetimin e ngritjes së produktivitetit në punë. Kurse, lëvizja e një punëtori nga pozita xehetar me kualifikim të lartë në pastrues ka ndodh për shkak shëndetësorë të punëtorit.

Ndërsa sipas zyrtarëve të NJB Kopaonik-Leposaviç, lëvizjet e stafit kanë ndodhur si shkak i nevojave të procesit dhe organizimit të punës, në përputhje me kualifikimin e tyre arsimor dhe në bazë të pëlqimit të marrë paraprakisht nga të dyja njësitë biznesore, dhe se në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit lidhet një aneks i kontratës së punës, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale të punës ndërmjet këtyre palëve kontraktuese.

Gradimet e stafit, pa qenë të bazuara në rregullore dhe politika të brendshme, mund të krijojnë pakënaqësi në mes të punëtorëve si dhe mundësinë që për kualifikimin e njëjtë punëtorët të mos marrin paga të njëjta. Përderisa lëvizjet nga njëra njësi biznesore në tjetrën mund të ndikojnë në uljen e produktivitetit në NJB prej të cilës është bërë transferi.

Të gjitha lëvizjet e stafit sipas pozitave të punës për njësitë organizative të Trepça Sh.A. janë paraqitur edhe në formë tabelare në *Shtojcën II të raportit, tabela 25*.

99. Informata rreth lëvizjes së stafit në NJB Kopaonik Leposaviç

3.5.4 Angazhimi i punëtorëve pa shpallje të konkursit publik, me punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta

Ligji i Punës¹⁰⁰ për punë dhe detyra specifike lejon lidhjen e kontratës në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit për një periudhë jo më të gjatë se 120 ditë brenda një viti. Me rastin e krijimit të marrëdhënies së punës, punëdhënësi është i obliguar që të shpall konkurs publik.

Trepça Sh.A përveç punëtorëve të rregullt, ka të angazhuar edhe punëtorë me Kontratë për Punë dhe Detyra Specifike. Numrin e të punësuarve me këto kontrata në Trepça Sh.A. e kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 22. Numri i të punësuarve me Kontratë për Punë dhe detyra Specifike nga njësitë biznesore Stan Tërg, Kishnicë-Artanë

Viti	Nr. i të punësuarve	Nr. i kontratave të nënshkruara	Nr. i punëtorëve me më shumë se një kontratë brenda një viti
2019	13	29	7
2020	62	83	8
2021	6	6	0
Total	81	118	15

Nga tabela më lart mund të vërehet se gjatë tri viteve në Trepça Sh.A. janë punësuar 81 punëtorë me Kontratë për punë dhe detyra specifike dhe se me të njëjtit janë lidhur 118¹⁰¹ kontrata, në vitin 2019 shtatë zyrtarë kanë lidhur më shumë se një kontratë brenda vitit me kohëzgjatje të ndryshme, ku për gjashtë prej tyre është tejkualuar kohëzgjatja e angazhimit më shumë se 120 ditë; në vitin 2020 tetë zyrtarë kanë nënshkruar më shumë se një kontratë brenda vitit ku për gjashtë prej tyre është tejkualuar kohëzgjatja e angazhimit më shumë se 120 ditë.; ndërsa në vitin 2021 janë pranuar vetëm gjashtë zyrtarë të cilët kanë nënshkruar vetëm një kontratë për punë dhe detyra specifike pa tejkallim të afatit ligjor. Angazhimi i këtyre zyrtarëve ka ndodhur në mungesë të një procesi transparent dhe konkurrues pa shpallje të konkursit publik.

Numrin e të angazhuarve me Kontrata për punë dhe Detyra Specifike, sipas Njësive dhe pozitive, për periudhën 2019-2021 e kemi paraqitur në *Shtojcën II të raportit, tabela 26.*

100. Ligji i punës Nr. 03/L-212, neni 8 dhe neni 10

101. Numri i kontratave për punë dhe detyra specifike për vitet 2019-2021

Duhet theksuar se të angazhuarit gjatë vitit 2019 pothuajse shumica prej tyre kanë mbuluar pozitat e rregullta të punës në zyret qendrore të Menaxhmentit ¹⁰². Ndërsa në vitin 2020, një pjesë e madhe e stafit të punësuar ishin angazhuar si punëtorë në Minierën e Stan Tërgut.

Në vitin 2019 Bordi Mbikëqyrës për nevojat e tij ka nxjerrë vendim ¹⁰³ për angazhimin e një Këshilltari të Jashtëm Ligjor për periudhë kohore prej gjashtë muajve me arsyetimin se ka volum të madh në hartimin e akteve të brendshme rregullative. Ndërsa, në vitin 2020, ka nxjerrë dy vendime ¹⁰⁴ për angazhimin e 55 praktikantëve fëmijë të minatorëve (minatorë të cilët kishin humbur jetën gjatë marrëdhënies së punës në Trepçë), për një periudhë 120 ditë. Në vendime nuk ishte specifikuar se për çfarë pozita të punës angazhohen si dhe në cilën NJB, dhe se nuk na është ofruar dëshmi tjetër se në bazë të çfarë kërkesave apo nevojave është bërë angazhimi i tyre.

Të angazhuarit me Kontrata për punë dhe detyra specifike në NJB Kopaonik-Leposaviç ¹⁰⁵ kanë mbuluar pozita të rregullta të punës. Si mostër, kemi përzgjedhur kontratat për pozitat Drejtor i Flotacionit, Drejtor Teknik i Flotacionit, si dhe Drejtor i Metalurgjisë së Plumbit. Vlen të theksohet se zyrtarët e angazhuar me këto kontrata, kanë qenë fillimisht staf i rregullt në Trepça Sh.A. mirëpo pasi që të njëjtit e kanë arritur moshën e pensionimit, janë angazhuar përmes këtyre kontratave pa shpallje të konkursit publik për mbulimin e këtyre pozitave të punës. Poashtu, edhe pse për pozitën Drejtor i Flotacionit kontrata për punë specifike ishte lidhur çdo vit për 120 ditë, sipas listës së pagave evidentohet se i njëjti zyrtar vazhonte të punoj gjatë gjithë vitit 2020 dhe 2021.

Angazhimi i këtyre punëtorëve nga menaxhmenti i Trepça Sh.A. ka ndodhur për shkak se nuk ishte arritur të bëhej vlerësim i duhur i nevojave për staf. Përderisa nga NJB Kopaonik-Leposaviç, angazhimi i tyre ka ndodhur pasiqë menaxhmenti ka vlerësuar nevojën për angazhimin e mëtutjeshëm të tyre në punë, në bazë të eksperiencës dhe profesionalizimit të treguar për një periudhë të gjatë kohore të angazhimit në Trepçë.

Mos aplikimi i procedurave të hapura të rekrutimit për angazhimin e punëtorëve me kontrata për punë dhe detyra specifike ka rezultuar në mos respektimin e parimit të transparencës, barazisë dhe kufizim të konkurrencës, kërkesa këto që derivojnë nga legjislacioni.

102. Parku Industrial Mitrovicë

103. Vendim i Bordit Mbikëqyrës i dt.22.07.2019

104. Vendime të Bordit Mbikëqyrës të dt.20.03.2020

105. Informata rreth të angazhuarve me kontrata për punë dhe detyra specifike NJB Kopaonik Leposaviç

3.5.5 Trajnimet e punonjësve nuk mbulojnë nevojat e njësive biznesore dhe nuk janë koordinuar si duhet

Aktivitet kryesor i kompanisë është: trajnimi i personelit në profesionet kyçe dhe objektet e minierave dhe prodhimit industrial¹⁰⁶. Zhvillimi i veprimtarisë së minierave kushtëzohet edhe me cilësinë e edukimit arsimor në përgatitjen e specialistëve të gjeologjisë, inxhinierisë, ekonomisë, hulumtimeve dhe profile të tjera që i takojnë fushës së minierave¹⁰⁷.

Selia qendrore e Trepça Sh.A. në PIM si qendër kryesore administrative nuk ka arritur të koordinoj aktivitetet e trajnimeve në relacion me njësitë e biznesit. Ne kemi konstatuar se në nivelin qendror mungojnë mekanizma të vlerësimit të nevojave për aktivitetet e trajnimit cilët janë të domosdoshëm për të vendosur standarde dhe procedura të zhvillimit të kapaciteteve njerëzore. Edhe pse aktivitetet e trajnimit mbulojnë nevojat bazike të njësive të biznesit këto trajnime nuk arrijnë të përmbushin nevojat e veprimtarisë dhe programet specifike të trajnimit nuk i përfshijnë të gjitha profilet e domosdoshme për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të ndërmarrjes.

Shkaktar i kësaj gjendje është se zyra qendrore nuk kishte mbledhur të dhënat për aktivitetet e trajnimit nga njësitë e biznesit. Të gjitha informatat për aktivitetet e trajnimit i posedojnë vetëm njësitë e biznesit¹⁰⁸. Sipas autoriteteve mungesa e fondeve ka ndikuar që vlerësimi i nevojave për trajnime nga niveli qendrorë i ndërmarrjes të mos mund të iniciohet fare¹⁰⁹. Si pasojë e kësaj shkakutje të nivelit qendrorë me atë lokal, zyra qendrore e burimeve njerëzore nuk ka informata për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve trajnuese të njësive biznesore për vitet 2019-2021¹¹⁰.

Ndërsa ,shkaktari i mungesës së trajnimeve që mbulon të gjitha nevojat e veprimtarisë është fillimisht mungesa e analizës dhe vlerësimit të nevojave¹¹¹. Theksojmë gjithashtu se ndikim të veçantë në stagnimin e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore ka pasur edhe mungesa e fondeve dhe e ndarjes së tyre për këtë qëllim¹¹². Kjo problematikë ndikon që ndërmarrjes t'i mungoj programi gjithëpërfshirës që do të ofroj pasqyrën e të gjitha profesioneve dhe profileve të nevojshme për zhvillimin e organizatës. Mungesa e një moduli programorë për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore ka për pasojë mungesën e një procedure të standardizuar e cila do të lehtësonte trajnimin e stafit dhe përgatitjen

106. Statuti NP Trepça Sh.A., neni 11, pika 2

107. Strategjia minerare e Republikës së Kosovës https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Minerare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf Objektivi II.1. Zhvillimi institucional dhe i kapaciteteve njerëzore, Ref 2.1

108. Pyetësi i plotësuar me datën ZKF 09.02.2022, Takimet zyrtare, komunikimi zyrtar me NJB Kopaonik-Leposaviç gjate datave 07.03.2022-21.03.2022

109. Raporti analitik nga DBNJ, përgjigje nga autoritetet dt.; 11.02.2022

110. Përgjigjet ne pyetësin e dt. 09.02.2022, ZKF

111. Përgjigje nga burimet njerëzore, dt. 14.02.2022

112. Përgjigje në pyetësorët e njësive, dt. 11.03.2022 & 14.03.2022

e tyre për procesin e prodhimit. Si rrjedhojë organizata nuk ka siguruar procedurat për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.

Mungesa e informatave, koordinimit dhe bashkëpunimit në nivel qendrorë ndikon negativisht në mbarëvajtjen e aktiviteteve trajnuese dhe vlerësimin e situatës. Edhe nëse problemet financiare do të zbuteshin në një afat të shkurtër kohorë, nuk dihet se cilat do të jenë aktivitetet e ndërmarra për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të ndërmarrjes. Vlen të ceket se mosha e stafit në prodhim aktualisht tejkalon mesataren prej 45 vitesh, gjë e cila tregon se ndërmarrja i ekspozohet rrezikut për mungesë të stafit të trajnuar profesionalisht në të ardhmen¹¹³. Theksojmë se mungesa e stafit profesional vështirëson arritjen e rezultateve të synuara dhe plotësimin e objektivave të ndërmarrjes¹¹⁴.

113. Dokumenti nga NJB Kopaonik-Leposaviç “Struktura e moshës së punëtorëve”, 01.10.2021

114. Biznes plani i vitit 2022, Swot analiza për rreziqet dhe mangësitë & Listat e punëtorëve

4 Konkluzionet

Trepça Sh.A. nuk ka arritur të vendosë sisteme dhe kontrole adekuate të cilat e mbështesin arritjen e performancës financiare dhe operative pozitive, me theks në procesin e prodhimit.

Trepça Sh.A. nuk ka arritur që të krijojë parakushtet e duhura për operim të cilat do të siguronin shfrytëzim efikas dhe fitimprurës të burimeve minerare. Faktor jo më pak determinues në ngecje të përmbushjes së objektivave ishin lëvizjet dhe ndryshimet e shpeshta të zyrtarëve në pozitat e larta menaxhuese.

Bordi menaxhues i NP Trepça Sh.A nuk ka arritur ti ushtroj kompetencat e veta në të gjitha njësitë biznesore të Trepça Sh.A. NJB Kopaonik-Leposaviç nga aspekti organizativ, rregullativ dhe financiar ka operuar në mënyrë të ndarë edhe pse në bazë të ligjit është njësi e pandashme e Trepça Sh.A, për më tepër as për afarizmin e saj nuk ka raportuar tek Bordi Mbikqyrës dhe Kryeshefi Ekzekutiv. Për çdo vit fiskal ka hartuar Planin e Biznesit si dhe Raportin Vjetor të aktivitetit operativ dhe financiar të kësaj njësie biznesore të Trepça Sh.A. Mirëpo këto plane dhe raporte nuk janë miratuar edhe nga Bordi Mbikëqyrës të cilët kanë për detyrë dhe përgjegjësi miratimin e raportit vjetor të shoqërisë dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve. Njëkohësisht rregulloret me të cilat operon NJB Kopaonik- Leposaviç nuk janë rishikuar dhe miratuar në Bord edhe pse për miratimin, ndryshimin, plotësimin si dhe shfuqizimin e Rregulloreve është kompetencë e Aksionarit përfshirë edhe miratimin e Planit të Biznesit. Ndërsa, NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë nuk kishte të aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës Planin e Biznesit për vitin 2019.

Trepça Sh.A. ka funksionuar pa rregullore dhe procedura të brendshme të miratuara në Bordin Mbikëqyrës për operim dhe menaxhim financiar , ku do të përshkruheshin dhe detajizoheshin punët, aktivitetet, procedurat dhe proceset. Për më tepër mungojnë procedurat standarde të operimit të miratuara në Bordin Mbikëqyrës, që përshkruajnë dhe detajizojnë punët, aktivitetet, dhe procedurat brenda Departamentit të Shitjes, si dhe përcaktimin e mënyrës së funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij departamenti dhe bashkëveprimin me departamentet dhe njësitë tjera. Si shkaktar tjetër tek menaxhimi i kompanisë është edhe mungesa e rregullores për përshkrimin/sistematizimin e vendeve të punës, e cila krijon menaxhim jo të duhur të burimeve njerëzore, si dhe vështirësi në funksionimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Trepça Sh.A. nuk kishte arritur të hartoj të gjitha aktet e brendshme përmes të cilave do të rregullohej në mënyrë të duhur fusha e burimeve njerëzore me qëllim të sigurimit të procesit efektiv të prodhimit. Përderisa, NJB Kopaonik-Leposaviç nuk ka arritur të përditësoj rregulloret dhe politikat e brendshme si dhe të njëjtat t'i shqyrtoj dhe të aprovoj në nivel të Bordit Mbikëqyrës.

Kompania nuk kishte emëruar zyrtar për certifikimin e pagesave. Këtë rol e mbulonte pjesërisht, Zyrtari Kryesor Financiar, mirëpo kjo nuk është një ndarje e duhur e detyrave pasi që i njëjti menaxhon edhe me llogaritë bankare dhe bën certifikimin e pagesave. Për

më tepër, pozita e zyrtarit certifikues nuk ishte paraparë as në strukturën organizative të kompanisë. Sipas konfirmimeve të U.d. Kryeshefit Ekzekutiv, kjo pozitë do të mbulohet përmes procedurave të rekrutimit.

Trepça Sh.A. nuk ka arritur të sigurojë sistem adekuat të kontrollit për shfrytëzim efikas dhe fitimprurës të burimeve minerare dhe vendos sistem të duhur operimi. Njësitë biznesore aktive prodhuese të koncentrateve të plumbit dhe zinkut nuk kishin arritur të realizonin planet e prodhimit sipas planifikimit për periudhën 2019-2021. Devijimet e realizimit të planeve të prodhimit nga planifikimi për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë ishin rrjedhojë e ndërprerjeve në punë nga punëtorët në prodhim për shkak të mos pagesës së pagave me kohë, ndërprerjeve në procesin e prodhimit si rezultat i mungesës së lëndës së parë për shkak të mos pagesës së obligimeve me kohë ndaj kontraktorëve, prishjeve teknike të makinerisë gjatë procesit të prodhimit, dhe rrezikut nga përmbytja e minierave.

Flotacionet e Trepça Sh.A. nuk kanë standardizuar proceset e punës duke adaptuar ISO standardet gjatë procesit të flotimit, analizave në laboratorë për kualitetin e xehes dhe përbërjen e koncentrateve të plumbit dhe zinkut. Poashtu nuk kemi arritur të sigurojmë manuale dhe procedura standarde të operimit që rregullojnë në mënyrë të detajizuar procesin.

Analizat e indikatorëve të likuiditetit, rentabilitetit dhe aktivitetit kanë rezultuar me tregues negativ që paraqesin gjendjen e rënduar financiare të kompanisë. Trepça Sh.A. për vite radhazi ka operuar me humbje. Nga këto analiza vërejmë se indikatorët e likuiditetit, rentabilitetit dhe aktivitetit kanë rezultuar me varianca negative të vazhdueshme ndër vite, me theks të veçantë raporti i fitimit të operimit, marzha e fitimit neto, raporti i kostonë së mallit të shitur, likuiditeti rrjedhës, likuiditeti i shpejtë dhe treguesit e tjerë që pasqyrojnë rezultatin e operimit me humbje.

Kosto e mallit të shitur të realizuar për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë, nga viti 2019 në vitin 2020 ishte rritur dukshëm ndërsa kishte një zvogëlim të lehtë gjatë vitit 2021. Poashtu, vërejmë disproporcion të dukshëm mes kostove të larta të shitjes dhe nivelit të prodhimit nëpër vite me theks të veçantë për vitin 2019. Kosto e mallit të shitur e prezantuar për NJB Kopaonik-Leposaviç, kishte shënuar trend rritës nga viti 2019 në vitin 2020 dhe duke pësuar rënie gjatë vitit 2021.

Trendi rritës i obligimeve ndër vite ishte evident për Trepça Sh.A. si rrjedhojë e gjendjes së rënduar financiare dhe mungesës së planit për prioritizim të pagesave ndaj furnitorëve.

Regjistri i llogarive për kërkesat e arkëtueshme kishte shënuar trend rritës vit pas viti si për Trepça Sh.A. Këto llogari përfshijnë mjete të cilat pret t'i realizoj sipas marrëveshjeve kontraktuale me blerësit dhe qiramarrësit, dhe të cilat nuk janë realizuar si shkak i vonësve në barazime të faturave finale për shitje të koncentrateve, dhe përfshijnë edhe saldo të bartura nga vitet paraprake.

Trepça Sh.A. ka numër të madh të rasteve me të cilat ballafaqohet si në cilësinë e palës debitoare, poashtu edhe kreditore, në konteste gjyqësore dhe përmbarimore, dhe të cilat rrezikojnë kompaninë me realizim sipas vendimeve të gjykatave dhe urdhëresave përmbarimore. Ndërsa NJB Kopaonik-Leposaviç për disa vite rradhazi ballafaqohet në kontest gjyqësor me ATK.

Teknologjia dhe infrastruktura e prodhimit në Trepça Sh.A. e trashëguar kryesisht nga vitet '60 dhe '70 dhe poashtu edhe nga vitet e mëhershme, është në gjendje të rënduar dhe për pasojë ka ndikuar në produktivitet të ulët, njëkohësisht edhe me shpenzime të larta të mirëmbajtjes së makinerisë. Trepça Sh.A. edhe pse kishte bërë vlerësim të nevojave për investime kapitale si dhe ka realizuar investime kapitale kryesisht të financuara nga aksionari kryesor Qeveria e Kosovës, ende nuk ka arritur që të realizoj investime për të gjitha projektet kapitale të planifikuara dhe në përputhje me nevojat e tyre, me qëllim të ngritjes së produktivitetit të nxjerrjes së xehes si dhe prodhimit të koncentratit, si bazë për zhvillim të mëtejshëm të industrisë metalurgjike. Trepça Sh.A. ka numër të madh të projekteve kapitale në pritje të financimit nga buxheti vetanak apo Qeveria, mirëpo të cilat nuk janë realizuar për shkak të gjendjes së rënduar financiare në vazhdimësi, si dhe nuk janë financuar as nga aksionari.

Flotacioni në Kishnicë dhe Flotacioni në Tunelin e Parë kanë rrjedhje (humbje) të mëdha të metaleve në steril gjatë procesit të flotimit të xeheve dhe prodhimit të koncentratit të plumbit dhe zinkut. Humbje më të mëdha janë identifikuar në Flotacionin në Kishnicë në krahasim me Flotacionin Tuneli i Parë

Trepça Sh.A. nuk kishte arritur të sigurojë menaxhim optimal të burimeve njerëzore në procesin e prodhimit. Trepça Sh.A. nuk ka të rregulluar siç duhet fushën e burimeve njerëzore dhe si pasojë nuk kishte arritur të sigurojë proces efektiv dhe efikas të prodhimit. Trepça Sh.A. nuk ka arritur që të bëjë identifikim të mirë të nevojave dhe orientimit të fuqisë punëtore në procesin e prodhimit, dhe kjo ka ndikuar në produktivitet të ulët të prodhimit, si dhe nuk ka arritur që të bëjë rekrutimin e tyre në përputhje me vendet e lira të shpallura me konkurs publik.

Mbulimi i pozitave të rregullta me punonjës përmes kontratave për punë e detyra specifike dhe mos zhvillimi i procedurave të rekrutimit, përveç që tregon mos pajtueshmërinë me kërkesat ligjore, tregon edhe për menaxhimin jo të mirë të burimeve njerëzore. Një nga shkaktarët tek burimet njerëzore është edhe mungesa e një politike për avancimet e stafit nga njëra pozitë në tjetrën, e cila rrit rrezikun për trajtim jo të barabartë në mes të punëtorëve.

Trepça Sh.A. nuk ka bërë vlerësim sistematik dhe nuk ka kryer analizë të përgjithshme për të gjitha angazhimet e nevojshme të fuqisë punëtore në procesin e prodhimit. Shërbimet bazike të trajnimit ofrohen në tre njësitë biznesore. Mirëpo specifikë e të gjitha njësive biznesore është se ka nevoja të theksuara për kuadro të reja dhe mungesë të profileve profesionale si ekonomisë, gjeodezisë, metalurgjisë etj. Shkaktari i mungesës së trajnimeve të duhura të organizatës është mungesa e analizës gjithëpërfshirëse të nevojave për trajnime për të gjitha njësitë biznesore.

5 Rekomandimet

Rekomandojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës:

1. Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar rivlerësimin e aseteve të Trepça Sh.A.
2. Të sigurojë raportimin e konsoliduar të pasurisë , detyrimeve, kapitalit, të ardhurave, shpenzimeve, rrjedhës së parasë dhe ekuitetit të Trepça Sh.A.
3. Të sigurojë se Aksionari dhe Bordi ushtrojnë kompetencat e tyre në të gjitha njësitë biznesore të Trepça Sh.A në mënyrë që të sigurohet konsistenca dhe konsolidimi organizativ, rregullativ dhe financiar për operim si një ndërmarrje e vetme.

Rekomandojmë Bordin Mbikëqyrës dhe Bordin Menaxhues të Trepça Sh.A.:

1. Të sigurojë hartimin dhe miratimin e Planit të Biznesit dhe Raportit Vjetor të integruar/konsoliduar të Trepça Sh.A., duke përfshirë edhe njësinë biznesore Kopaonik-Leposaviç.
2. Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për bashkëpunim dhe koordinim me NJB Kopaonik-Leposaviç në nivel Bordi dhe Menaxhmenti të Trepça Sh.A.
3. Të fuqizojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë hartimin, rishikimin dhe aprovimin e rregulloreve të brendshme të funksionimit, operimit, menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore në nivel të të gjitha njësive biznesore të Trepça Sh.A. si dhe të sigurojë zbatimin e tyre.
4. Të sigurojë aktivitete efektive operative dhe financiare në nivel të të gjitha njësive biznesore në mënyrë që të mundësojë arritjen e pikës së rentabilitetit dhe ngritjen e vazhdueshme drejt operimit me fitim.
5. Të siguroj realizimin e planeve të prodhimit dhe ngritje të niveleve të prodhimit në vazhdimësi , duke mundësuar edhe rritjen e nivelit të shitjeve gjatë vitit dhe rrjedhimisht edhe të hyrave.
 - 5.1 Të standardizojë proceset e punës duke adaptuar ISO standardet gjatë procesit të flotimit të xehes në flotacione, dhe analizave në laboratorë për kualitetin e xehes dhe përbërjen e metaleve në koncentre.
 - 5.2 Të siguroj vendosjen e procedurave dhe standardeve të operimit, përfshirë investimet kapitale në pajisje dhe makineri prodhuese bazuar në analizë paraprake kost benefit, për reduktimin optimal të rrjedhjeve (humbjeve) të metaleve në steril.
6. Të sigurojë siguroj plotësimin e pozitave të punës të cilat parashihen me rregullore dhe në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës, duke mundësuar forcim të kontrolleve të brendshme, parandalim të konflikteve të interesit dhe respektim të rregullave të kontrollit dhe menaxhimit financiar.

7. Të sigurojë rishikim në baza periodike të shpenzimeve direkte të prodhimit dhe kostos së shitjeve si dhe të reduktojë/racionalizojë shpenzimet e panevojshme aty ku është e mundur të aplikohet.
 - 7.1 Të sigurojë rishikim në baza periodike të obligimeve ndaj furnitorëve dhe obligimeve tjera dhe të sigurojë listë të prioriteteve për pagesë të obligimeve dhe në rastet ku është e favorshme të aplikojë alternativa për pagesë me këste.
 - 7.2 Të sigurojë rishikim në baza periodike të llogarive të arkëtueshme, analiza të rregullta të vjetërsisë së llogarive që të përmirësoj arkëtimet dhe barazimet me klientët për realizim të të hyrave brenda afateve optimale kohore dhe sipas mundësive aty ku është e favorshme të aplikojë edhe alternativat ligjore. Poashtu të bëjë vlerësime të sakta për provizionimin e borgjeve të këqija.
8. Të analizojë në baza periodike rastet me të cilat ballafaqohet kompania si në konteste gjyqësore dhe përmbartimore, dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme përmes zyrës ligjore brenda afateve optimale.
9. Të rishikojë në baza periodike variancat mes zërave financiare dhe shqyrtojë shkaqet e operimit me humbje
10. Të siguroj prioritizimin e projekteve kapitale për financim gjithëpërfshirës në nivel të njësive biznesore dhe të bëhet një vlerësim më i mirë i nevojave për investim të cilat ndikojnë në rritjen e kapacitetit të prodhimit.
 - 10.1 Të siguroj alternativa dhe plan konkret për burimet e financimit të projekteve kapitale në pritje, me qëllim të ngritjes së produktivitetit në procesin e prodhimit.
11. Të siguroj se Udhëheqësit e NJB bëjnë identifikimin e nevojave për numrin e duhur të punëtorëve për angazhim direkt në procesin e prodhimit, në mënyrë që të arrihet eksplotimi i resurseve minerare dhe prodhimi me kapacitete të ngritura.
 - 11.1 Të siguroj analizë dhe identifikimin e saktë dhe të qartë të nevojave për angazhimin e fuqisë punëtore.
12. Të siguroj se Trepça Sh.A. bën angazhimin e punonjësve me kontrata për punë dhe detyra specifike vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda kompanisë, por kërkohet ekspert i një fushe specifike. Njëkohësisht të sigurojë respektimin e afateve kohore për angazhimin e tyre në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.
13. Të bëjë analizë për vlerësim të nevojave për trajnimet e stafit në nivel të kompanisë dhe të siguroj angazhimin e njësive të biznesit për hartimin e një programi të përbashkët dhe gjithëpërfshirës të trajnimeve me të gjitha modulet e nevojshme.

Shtojca I. Motivi i auditimit, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Motivi i auditimit

Përkundër transformimit nga NSH, NP Trepça Sh.A për vite rradhazi ballafaqohet me probleme dhe sfida të shumta. Produktiviteti i ulët i prodhimit dhe mungesa e shfrytëzimit të kapaciteteve të plota si rrjedhojë e teknologjisë së vjetëruar në miniera dhe flotacione¹¹⁵, mungesa e investimeve kapitale për ngritje të kapaciteteve me teknologji bashkëkohore prodhuese si dhe hulumtim të rezervave dhe resurseve minerale, mosha e vjetër e stafit të kualifikuar në procesin e prodhimit¹¹⁶ si dhe mungesa e trajnimeve, janë ndër sfidat kryesore që e karakterizojnë performancën operative të Trepça Sh.A.¹¹⁷ Disa njësi biznesore janë pasive dhe nuk gjenerojnë të hyra nga prodhimi dhe se aktualisht krijojnë vetëm shpenzime të mirëmbajtjes dhe pagave të stafit.¹¹⁸ Ndërsa mungon një rivlerësim i jashtëm kredibil për asetet e kompanisë, i cili nuk është kryer asnjëherë deri më tani që nga periudha e pas luftës në Kosovë.¹¹⁹

Mungesa e rentabilitetit dhe operimi me humbje në vazhdimësi për vite rradhazi¹²⁰: [Trepça Sh.A. NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë dhe të tjera, me trend operimi me humbje si në vijim: viti 2018 (2,211,138€), viti 2019 (3,466,684€), viti 2020 (4,730,257€), viti 2021 (689,468€); NJB Kopaonik-Leposaviç me trend të operimit me humbje si në vijim: viti 2019 (883,794€), viti 2020 (1,977,227€), viti 2021 (719,820€)], mungesa e kapitalit vetanak për zhvillimin e kapaciteteve prodhuese si dhe varësia e vazhdueshme për subvencionim nga aksionari respektivisht Qeveria lidhur me mbulimin e shpenzimeve operative, për paga dhe investime kapitale¹²¹, janë disa nga treguesit e dobësive të performancës financiare të kompanisë.¹²²

115. <https://ekonomiaonline.com/ekonomi/rimekembja-e-ngadalte-e-trepces/>

116. <https://www.buletiniekonomik.com/2020/01/23/trepca-po-kerkon-mbi-200-punetore-te-rinj-probleme-me-paga/>

117. Raportet vjetore për vitin 2019 dhe 2020, Trepça Sh.A. ;Plani i Biznesit për vitin 2020, dhe 2021 , Trepça Sh.A.

118. Raportet vjetore për vitin 2019 dhe 2020, Trepça Sh.A.

119. Intervista gjatë fazës parastudimore me Zyrтарin e Aseteve, Trepça Sh.A.

120. Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2018 Trepça Sh.A. ; Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2019 Trepça Sh.A. ; Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2020 Trepça Sh.A.; Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2021 Trepça Sh.A.; Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2019 Trepça NJB Kopaonik-Leposaviç ; Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2020 Trepça NJB Kopaonik-Leposaviç; Raporti i Auditorit të Pavarur për PFV 2021 Trepça NJB Kopaonik-Leposaviç

121. Plani i Biznesit për vitin 2020, dhe 2021 ; Marrëveshje e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të MEPTINIS-NJPMNP dhe Trepça Sh.A. për vitin 2020; Marrëveshje e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të MEA-NJPMNP dhe Trepça Sh.A për vitin 2021; Marrëveshje e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të MZHE-Departamenti i Minierave dhe Trepça për vitin 2019; dhe Marrëveshje e Monitorimit dhe Kontrollit në mes të MZHE-Departamenti i Minierave dhe Trepça për vitin 2018; <https://kallxo.com/lajm/punetoret-e-trepces-ende-pa-rroga/> , <https://telegrafi.com/minatoret-pa-paga-ne-trepce-nuk-eshte-duke-punuar-askush/>

122. <https://telegrafi.com/trepca-ka-kushtuar-buxhetit-rreth-120-milione-euro-qe-nga-paslufta/>

Krahas shpenzimeve të larta prodhuese, operative dhe për paga, mungojnë politikat dhe rregulloret e brendshme që përcaktojnë kriteret dhe standardet për këto shpenzime. Trendi i rritjes së obligimeve ndër vite ndaj furnitorëve/kontraktorëve¹²³, si dhe trendi i rritjes së llogarive të arkëtueshme dhe mos realizimit të arkëtimit të të hyrave me kohë nga shitja e koncentrateve dhe të hyrave tjera operative, pasqyrojnë situatën e rënduar të likuiditetit.¹²⁴

Problemet e theksuara më lartë brenda këtij kapitulli paraqesin treguesit kyç për të inicuar këtë auditim, si dhe duke marrë parasysh ndikimin dhe peshën e këtij resursi pasuror për Kosovën në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit, gjenerimin e punësimit, rritjen e eksportit dhe BPV-në.

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i auditimit përfshinë aktivitetin prodhues dhe financiar të Trepça Sh.A me njësitë biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg, Minierat me Flotacion Kishnicë - Artanë, si dhe Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç. Analizat tona shtrihen edhe në aktivitetet e njësive tjera biznesore jo-prodaktive dhe jo-profitabile.

Auditimi mbulon periudhën kohore 2019-2021. Përcaktimi i kësaj periudhe është bërë me qëllim të përfshirjes në auditim të informacioneve relevante të fundit. Ndërsa për qëllime krahasuese dhe analitike janë përdorur të dhëna deri në pesë (5) vite paraprake.

Metodologjia e auditimit

Metodologjia jonë e auditimit është bazuar në qasjen për të siguruar auditim efikas. Ne kemi zhvilluar një strategji dhe qasje të detajuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit në mënyrë që auditimi të kryhet në mënyrë efikase dhe në kohën e duhur dhe që do të na shpie në identifikimin e mangësive të proceseve respektivisht aktiviteteve. Qëllimi ynë është të sigurohet se çështjeve të auditimit iu kushtohet rëndësia dhe trajtimi i duhur bazuar në synimin për arritjen e objektivave të këtij auditimi.

Për këtë auditim janë përdorur një varg teknikash për të marrë dëshmi dhe siguri të auditimit, duke u siguruar se këto dëshmi janë relevante, të besueshme dhe të mjaftueshme, si dhe bazohet në një kuptim të plotë të biznesit dhe operacioneve të entitetit. Burimet e të dhënave për punën audituese janë nga menaxhmenti si dhe njësitë biznesore të Trepça Sh.A. Duhet theksuar se ka pasiguri materiale rreth informatave financiare dhe saldove të bartura ndër vite për shkak se softueri i kontabilitetit i cili përdoret për njësitë biznesore Stan Tërg dhe Kishnicë-Artanë nuk gjeneron librin kryesor sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, poashtu pasuria duke përfshirë edhe stoqet e Trepça Sh.A. mbahen në formatin excel të ndarë nga softueri. Softueri është windows aplikacion i cili përdoret që nga viti 2009, nuk përmban të gjitha modulet si dhe

123. <https://kallxo.com/lajm/trepces-i-bllokohen-llogarite-shkak-borxhet/>

124. Raportet e Auditorit të pavarur për PFV sipas pikës 7 të lartcekura

nuk integron/konsolidon informatat financiare për të gjitha njësitë biznesore të Trepça Sh.A. përfshirë gjenerimin e raporteve dhe pasqyrave financiare të konsoliduara. Mos konsistenca në raportim financiar është përcjellur ndër vite.

Metodat e përdorura në këtë auditim përfshijnë:

- Intervistat me personelin kyç të entitetit dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për të identifikuar zhvillimet që ndikojnë në organizatë (si të brendshme ashtu edhe të jashtme), si dhe për të marrë të dhënat dhe informatat e nevojshme;
- Analizimi i kornizës relevante ligjore, institucionale dhe të industrisë;
- Analizimi i kornizës së brendshme rregullative dhe funksionale të entitetit;
- Analizimi i dokumenteve tjera relevante të aktivitetit biznesor;
- Analizimi i raporteve të përgatitura për autoritetet e jashtme relevante;
- Analizimin e planeve të brendshme, strategjive, analizave, procesverbaleve, dhe raporteve përfshirë raportet e monitorimit të aktiviteteve;
- Kontrollat financiare kyçe dhe siguria që mund të marrim nga to;
- Analizimi i raporteve të brendshme operative dhe financiare, dokumentacionit relevant kontabël dhe financiar, përfshirë pasqyrat financiare;
- Rishikimi analitik i zërave dhe saldove financiare;
- Analiza tjera financiare dhe menaxheriale, relevante për auditimin;
- Dërgimi i letër konfirmimeve tek palët e treta me qëllim të përfitimit të dëshmive të auditimit;
- Aplikimin e qasjes së mostrimit;
- Ekzaminimi i korrespondencave ndërmjet palëve relevante në çështjet që lidhen me auditimin tonë;
- Vëzhgimi dhe inspektimi fizik në terren;
- Dokumentacion tjetër relevant për qëllime të punës tonë audituese.

Shtojca II. Tabelat për gjetjet e auditimit nga Kapitulli 3

Tabela 23. Shpenzimet e prodhimit për vitet 2019-2021, NJB Stan Tërg, NJB Kishnicë-Artanë¹²⁵ dhe NJB Kopaonik - Leposaviç

NJB Kopaonik - Leposaviç				NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë	
Shpenzimet direkte të prodhimit	Viti 2021 (Euro)	Viti 2020 (Euro)	Viti 2019 (Euro)	Shpenzimet direkte të prodhimit	Viti 2019 (Euro)
Kostot e materialit ndihmës në prodhim	144,617	140,413	212,641	Eksplziv, detonatorë	280,822
Kostot e gëlqeres për flotacion	41,455	73,891	73,029	Repromateriale për miniera	35,450
Shpenzimet për materiale elektrike	14,840	39,657	29,150	Reagensa	240,573
Shpenzime për materiale për ndërtim në korridore të horizonteve	181,887	281,329	158,635	Scera çeliku	37,191
Shpenzime për toptha të mullirit	23,815	426,147	277,926	Vajra dhe yndyrna industriale	11,696
Shpenzime për reagensa	371,189	470,295	325,283	Karburante dhe vajra për makina produktive	101,882
Shpenzime për pluhur të hirit	9,034	12,038	11,277	Materiale për prodhim për njesit tjera	5,847
Shpenzime për detonatorë dhe eksploziv	496,288	726,651	596,114	Fluide-Azot, Acetilen, Oksigjen	6,807
Shpenzime për pjesë rezervë	408,009	106,592	50,223	Materiale elektrike për mirëmbajtje të paisjeve	18,148
Shpenzime për goma të makinave	144,446	135,045	130,730	Materiale mekanike për mirëmbajtje të paisjeve	51,995

125. Për vitin 2020 shpenzimet direkte të prodhimit ishin 2,335,543€ ndërsa për vitin 2021 ishin 2,315,691€. Për këto dy vite nuk kishte shpalosje të shpenzimeve direkte të prodhimit për NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë.

Shpenzime për produkte të naftës (karburanteve dhe lubrifikantëve)	348,321	375,546	376,428	Material i imët hargjues në prodhim	171,572
Shpenzime për benzinë	15,708	12,786	12,275	Material druri-dërrasa, shtafne, listella, etj	42
Shpenzime për mazut	88,246	-	104,558	Vegla të imta në përdorim	8,780
Vaj i përdorur	99,645	113,581	71,496	Vegla të imta-pjesë të pajisjeve	2,196
Material tjetër	116,974	20,287	91,448	Pjesë rezervë	349,094
Total	2,504,474	2,934,257	2,521,213	Auto goma për makina produktive në përdorim	47,451
Shpenzime tjera direkte të prodhimit				Auto goma për makina jo produktive	771
				Shpenzime të materialit për riparim	2,309
				Shpenzime të materialit për mirëmbajtje	5,407
Shpenzime për kryerje të punëve sipas situacioneve	407,465	1,474,544	1,292,228	Shpenzime të materialit për mirëmbajtje mekanike	5,433
Shpenzime për acide dhe acetat në shishe	28,260	19,032	30,940	Shpenzime të materialit ndërtimor për mirëmbajtje	22
Shpenzime për mjete të punës dhe inventar	29,342	15,509	18,368	Shpenzime për sistem e hidrobushjes së minierave	14,452
Shpenzime për shërbime tjera që lidhen me prodhim	13,302	15,674	5,607	Riparimet e veglave dhe pajisjeve	9,462
Shpenzime për materiale tjera	48,327	24,850	52,284	Shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve prodhuese	12,565
Total	526,697	1,549,609	1,399,427	Total	1,419,967

Tabela 24. Kontratat për furnizime me lëndë të parë prodhimi 2019-2021, NJB Stan Tërg dhe NJB Kishnicë-Artanë

Kontratat për furnizime me lëndë të parë prodhimi (€)	Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stan Tërg			Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Kishnicë-Artanë			Furnizimet e përbashkëta			Total
	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021	
Furnizim me Eksploziv	427,681	519,650	628,850		76,228					1,652,409
Furnizim me Derivate të naftës							184,000	161,500	155,000	500,500
Furnizim me Gazra teknike							11,184	8,016	9,530	28,730
Furnizim me sodë industriale NA2CO3							127,440	135,464	145,977	408,881
Furnizim me Gëlqere CaOH2/ gëlqere të hidratizuar							47,956	77,231	135,625	260,812
Furnizim me sulfate (sulfat zinku dhe sulfat bakri)			90,222				77,124	144,514		311,860
Furnizim me Ksantate		41,418					48,032		94,108	183,558
Furnizim me sfera dhe shufra për bluarjen e xehes	71,506	64,148	99,981		88,913					324,548
Furnizim me cianid (NaCN)	29,830	21,240							80,240	131,310
Furnizim me Dowfroth					33,984	32,214				66,198
Total 2019-2021										3,868,806

Tabela 24.1. Kontratat për furnizime me lëndë të parë prodhimi 2019-2021, NJB Kopaonik-Leposaviç

Kontratat për furnizime me lëndë të parë prodhimi (€)	Miniera Černac dhe Bello Bërdo			Flotacioni Leposaviç			Furnizimet e përbashkëta			Total
	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021	
Furnizim me toptha të mullirit				385,860	378,780					764,640
Furnizime me detonatorë dhe eksploziv	639,895	925,370	849,987							2,415,252
Furnizime me produkte të naftës (karburanteve dhe lubrifikantëve), benzinë dhe mazut							835,440		682,748	1,518,188
Furnizime me vaj të përdorur							104,045	93,681	123,453	321,179
Material ndërtues në korridoret e minierave			498,799							498,799
Furnizime me acide dhe acetat në shishe							9,582	9,582	21,897	41,061
Furnizim me gëlqere				89,810		90,860				180,760
Material ndërtues për korridore në miniera		375,907								375,907
Furnizime me reagensa					478,773					478,773
Furnizime me goma të makinave								124,544	104,576	229,120
Furnizim me pluhur të hirit të thatë ¹²⁶										-
Total 2019-2021										6,823,589

126. Marrëveshja e shitjes së hirit të thatë në mes të Korporatës Energetike të Kosovës Sh.A. dhe Trepça Sh.A. me ref. 9357 dt. 03/10/2019 e lidhur nga Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A. për periudhë 36 mujore në shumë 111,600€. Kjo kontratë shfrytëzohet edhe nga NJB Kopaonik-Leposaviç

Tabela 24.2. Punët e kontraktuara në prodhim për periudhën 2029-2021, NJB Kopaonik - Leposaviç

Përshkrimi kontratës	Vlera kontratës '000 (€)	Kohëzgjatja e kontratës
Punë kërkimore-përgatitore dhe nxjerrje të xeheve në horizontin V, VI, VII dhe VIII në Minierën Cërnac ¹²⁷	1,213,400	12 muaj me mundësi vazhdimi
Gërmimi i hapësirave horizontale dhe vertikale në minierën e Bello Bërdo ¹²⁸	477,980	12 muaj me mundësi vazhdimi
Punët përgatitore dhe gërmim i xeheve në horizontin V, VI, VII dhe VIII në Minierën Cërnac ¹²⁹	1,483,450	12 muaj me mundësi vazhdimi
Total	3,174,830	

127. Kontrata me numër reference 001/2020

128. Kontrata me numër reference TRBB 001/2020

129. Kontrata me numër reference TRC 001/2019

Tabela 25. Lëvizjet e stafit në pozita dhe Njësi Biznesore

Lëvizjet e stafit në mes të Njësive Biznesore		
NJB	Pozita paraprake	Pozita e re
Miniera me Flotacion Stan Tërg	Punëtor në shpime të thella	Vozitës në autopark
	Drejtues i shërbimit teknik	Punë shtesë - zyrtar për projekte, hulumtim, studim, analiza
	Drejtues i hidrombushjes me hi	Punë shtesë - zyrtar për projekte, hulumtim, studim, analiza
	Drejtues i transportit	Zyrtar i prokurimit
Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë	Punëtor në prodhim	Punëtor në prodhim
	Inxhinierë në prodhim	Inxhinierë në prodhim
	Kualifikim I lartë - xehetarë	Kualifikim I lartë - xehetarë
	Mbikqyrës miniere	Mbikqyrës miniere

Lëvizjet e stafit nga njëra pozitë në tjetrën brenda Njesisë Biznesore

NJB	Pozita paraprake	Pozita e re
Miniera me Flotacion Stan Tërg	Kryepunëtor në Minierë	Kryepunëtor në qarkullimin e lartë
	Punëtor në pompa	Zyrtar Ligjor
	Laborant i gravimetrisë	Kryepunëtor ndërrimi - njësia e laboratorit
	Brigadier i makinistëve në stabilimentet bartëse	Kryepunëtor në stabilimente bartëse
Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë	Kualifikim i ultë xehetarë	Kualifikim i lartë xehetarë
	Kualifikim i ultë xehetarë	Kualifikim i lartë xehetarë
	Kualifikim i lartë xehetarë	Mbikqyrës në Minierë
	Kualifikim i lartë xehetarë	Pastrues në banjo

Lëvizjet e stafit nga njëra pozitë në tjetrën, NJB Kopaonik - Leposaviç

NJB	Pozita paraprake	Pozita e re
Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç	Inxhinier prodhimi Flotacioni Leposaviç	Menaxher i prodhimit Flotacioni Leposaviç
	Drejtor Teknik i Minierës Crnac (vazhdon edhe si drejtor Teknik i Minierës)	Menaxher në Minierën Crnac
	Drejtor i Flotacionit Kopaonik Leposaviç	Drejtor i Minierës Crnac
	Drejtor i Energjetikës (vazhdon edhe si drejtor i Energjetikës)	Ndihmës menaxher për zhvillim, mirëmbajtje dhe energji
	Punëtor i thjeshtë	Asistent i minatorit Crnac
	Asistent i minatorit në minierën Belobrd	Mbikëqyrës i ndërrimit në minierën Belobrd
	Asistent minator në minierën Belobrd	Minator në minierën Belobrd
	Minator në minierën Belobrd	Minator i lartë në minierën Belobrd
	Inxhinier miniere	Drejtues i shkrites


Tabela 26. Numri dhe pozitat e të angazhuarve me kontrata për punë dhe detyra specifike¹³⁰

	2021	2020	2019
Menaxhment	1- Mjek në QMP 1- Kontabilist i çertifikuar	1 - Infirmiere 1 - Kontabilist i çertifikuar 1 - Këshilltar Ligjor I KE	1- Vozitës 1- Kontabilist i Çertifikuar 3 - Këshilltar Ligjor i KE 1 - Këshilltar I Jashtëm i Bordit Mbikqyrës 1 - Profesoresh e gjuhës angleze
NJB Miniera me Flotacion Stan Tërg	1 - Kalkulues i mëditjeve	49 - Punëtorë në Minierë 4 - Asistente administrative 1 - Këshilltar rreth procesit të flotimit 1 - Për punë dhe detyra specifike	1 - për punë dhe detyra specifike 1 - këshilltarë rreth procesit të flotimit
NJB Miniera me Flotacion Kishnicë-Artanë	1 - Këshilltar rreth procesit të flotimit 1 - Këshilltarë në fushën e Makinerisë	2 - Punëtorë në Minierë 1 - Këshilltar në fushën e Makinerisë	1- Elektricitist 1 - Inxhinjerë i Makinerisë
NJB Fabrika e Pajimeve dhe Proceve	/	1- Punëtorë	1- Punëtorë
Zyra Administrative në Prishtinë	/	/	1- Zyrtare administrative
Terminali Doganor	1- Zyrtar	/	/
Administratë - NJB Kopaonik Leposaviç	1- Zëvendës Menaxher	1- Zëvendës Menaxher 1- Këshilltar I Menaxherit për Zhvillim	1 - Zëvendës Menaxher 1- Këshilltar I Menaxherit për Zhvillim
NJB Kopaonik Leposaviç	1- Drejtor I Flotacionit	1- Drejtor i Flotacionit 1 - Drejtor Teknik i Flotacionit	1- Drejtor i Flotacionit 1- Drejtor Teknik i Flotacionit
Metalurgjia e Plumbit - NJB Kopaonik Leposaviç	1 - Drejtor i Metalurgjisë së Plumbit	/	/

130. Informata për stafin me Kontrata për punë dhe detyra specifike

Shtojca III. Struktura organizative

STRUKTURA ORGANIZATIVE E TREPÇA SH.A.



Në kuadër të kësaj strukture nuk janë përfshirë departamentet/divizionet të cilat ende vazhdojnë të funksionojnë në bazë të organogramit të aprovuar gjatë periudhës së administrimit të NSH Trepça nën AKP, si : Administrata, Departamenti për Hulumtim dhe Zhvillim ku përfshihet: Divizioni i Kontrollit, Divizioni i Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Divizioni i Planifikimit dhe Analizës; Departamenti i Prokurimit, Departamenti i Burimeve Njerëzore, Departamenti i Sigurisë Fizike, Qendra e Mjekësisë së Punës, si dhe Divizioni i Shitjes dhe Qirave).

Shtojca IV. Foto gjatë ekzaminimit fizik të procesit të prodhimit

Miniera me Flotacion Tuneli i Parë, Stan Tërg



Miniera me Flotacion Artanë-Kishnicë



Shtojca V. Letër konfirmim dhe komentet e entitetit të audituar

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonikarsko Društvo

Nr. 6742 Data 07.12.2022
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Mitrovicë, 07.12.2022

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A”** (në tekstin e mëtejme **“Raporti”**);
- pajtohem pjesërisht me të gjeturat dhe rekomandimet si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ud.Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A.
Enis Abdurrahmani





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo




Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: “Performanca financiare dhe operative NP Trepça Sh.A”

Dokumenti: Komentet nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit

Te gjeturat	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne raste te mospajtimit	Pikëpamja e ZKA-së
E gjetura 1	jo	ZAB në Trepça SH.A. gjatë periudhave kohore 2019 - 2021 ka përmbushur planin e auditimit në përjashtim të viti 2021 ku Komisioni i Auditimit të Trepça SH.A. ka kërkuar me anashkalu planin për auditime specifike, për çka janë dëshmi edhe procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura nga Komisioni i Auditimit.	Komenti nuk ndërlidhet me gjetjen 3.1.1 që ka të bëjë me Planet e biznesit, Raportet Vjetore dhe Rregulloret që nuk janë miratuar në Bordin Mbikqyrës për të gjitha njësitë biznesore, dhe se kjo gjetje nuk ka të bëjë me përmbushjen e planeve të NJAB. Ne nuk kemi pasur ne fushëveprim te auditimit trajtimin e aspektit të përmbushjes së planeve të auditimit të NJAB. Gjetja si e tillë qëndron.
E gjetura 4	jo	Mendojmë aase me një industri me teknologji të stërvjetruar nuk mun të aplikohen standarde respektivisht ISO standarde. Flotacionet e reja kërkojnë investime të mëdha me të cilat ne nuk	Ne kemi trajtuar infrastrukturën dhe teknologjinë në procesin e prodhimit duke përfshirë edhe flotacionet, si dhe subvencionet e destinuar nga aksionari –

		mundemi ti mbulojmë me buxhetin aktual dhe me të hyrat që i realizojmë.	Qeveria e Kosovës -ME-NJPMNP për investime kapitale si dhe realizimin e tyre (ref. seksioni 3.4 në raportin e auditimit). Adaptimi i ISO standardeve nuk ndërlidhet vetëm me teknologjinë, mirëpo me praktikat e punës gjatë gjithë ciklit të prodhimit duke përfshirë edhe analizat laboratorike për xehen e flotuar dhe të pa flotuar. Gjetja si e tillë qëndron.
--	--	--	---



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës